

# GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI  
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA  
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail: gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7833 E mërkurë 27 Mars 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

**Opinion** **i** **Ditës**

Konstanty Gebert është një gazetar dhe aktivist i të drejtave të hebrenjve në Poloni. Është ndër njerëzit hije që themeluan "Solidarnost"-in dhe e orientuan ...  
Vijon në faqen 20

Nga DRITAN HILA

A duhej ta linte shtetësinë shqiptare djali i Bujar Nishanit!



**Dje** **në** **Project Syndicate**

Presidenti francez, Emmanuel Macron, së fundmi prezantoi platformën e tij për zgjedhjet e ardhshme të Parlamentit Europian. Reagimet zyrtare ndaj qasjes ...  
Vijon në faqen 21

Nga DOMINIQUE MOISI

Ambicia që i nevojitet Europës



Sekuestrohet arma dhe 2 makina luksoze

## Ekzekutimi i Jurgen Kurtit, 3 të rinj në pranga, dyshimi për vrasje me pagesë

Policia: Kapëm autorët, mister porositësi. Kamerat filmuan automjetin që ndoqi menaxherin e VIP-ave

Policia e Shtetit ka zbardhur ngjarjen, kumbeti i vrarë Jurgen Kurti me 18 mars në rrugën "Zef Jubani" në Tiranë. Shtetësit e arrestuar si të dyshuar për vrasjen e Jurgen Kurti janë identifikuar si Elsi Levendi, Olsi Qalliaj dhe Alesio Berberi. Gjithashtu, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri "Pistoletë TT", fishekë luftarakë ...  
Në faqen 8

## ZV/MINISTRI I JASHEM: SHQIPERIA NUK ESHTË E MIQVE DHE KUSHERINJVE "FURTUNE" NE MEPJ, ÇAKAJ SHKARKON 20 DIPLOMATE

Gent Cakaj: Valë pastrimi në shërbimin diplomatik. Reagon Tritan Shehu: Po vendosni në terror diplomatët, ngjan me raprezaljet e vitit 1945



(Në foto) Kryeministri Edi Rama. Ish-ministri Ditmir Bushati dhe ministri i Jashtëm në detyrë, Gent Cakaj

- EMRAT NE ÇDO QARK**  
600 punonjësit e rinj në shëndetësi që do punësohen në shtet pas testimit  
Në faqen 12
- KUVENDI ME 99 DEPUTETE**  
Myslim Murrizi: Së shpejti bëjmë një grup parlamentar me 7 deputetë nga PD  
Në faqen 2
- SKEMA E RE E PERFITIMIT**  
Pagesa e PAK nuk ndërpritet edhe kur punësohesh, si ndryshojnë rregullat  
Në faqen 5

**LISTA EMERORE**



**ATP: 300 pronarët që marrin kompensim në Tiranë, Durrës Vlorë dhe Elbasan**  
Në faqen 7

## Ish-ministri i Brendshëm njihet me akuzën për grup kriminal dhe trafik droge

# Saimir Tahiri i pandehur: Jam ministër kampion

"Procesi, maskaradë. S'është ky sistemi i drejtësisë për të cilin luftova"

Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri ka folur pas vendimit të gjykatës për nisjen e gjykimit ndaj tij që e vendos zyrtarisht si të pandehur. Në një prononcim për mediat pas seancës 8 orëshe, Tahiri tha se të gjithë kishin shumë gjëra për të thënë por se më e rëndësishmja vjen.



"Zgjati se kam përshtypjen të gjithë kishin gjëra për të thënë lidhur me atë që parashtruan prokurorët. Më shumë se afati 8 orë i zgjatjes së seancës sot, më vjen keq vetëm për ju që u detyruat të prisnit. Ajo që vjen para është më e rëndësishme ...  
Në faqen 9

**SHOWBIZZ**

## Nga miq për kokë në armiq, VIP-at që "urrehen" me njëri-tjetrin

Suplement

# KRIZA POLITIKE ZGJIDHJA

Parlamenti me 99 deputetë të enjten, KQZ pritet të japë sot edhe 3 mandate

## Nisma, Murrizi: Së shpejti, grup të ri parlamentar me 7 deputetë nga PD-ja

Listave të kandidatëve po u vjen fundi në disa qarqe

Valentina Madani

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve do të mbledhet sot për t'u dhënë mandatin e deputetit 3 kandidatëve nga listat shumëvokale të Elbasanit, Shkodrës dhe Vlorës. KQZ-ja do t'u japë mandatin edhe tre emrave të tjerë të ardhur nga listat e PD-së dhe LSI-së. Ish-aleati i Lulzim Bashës, Adriatik Alimadhi, kreu i partisë Balli Kombëtar, i renditur i treti në listat e demokratëve në qarkun e Vlorës është një nga 3 deputetët e rinj që do t'u shtohet radhëve të opozitës në parlament, pasi të bëjë betimin në seancën e të enjtes. Ai do të marrë mandatin e Agron Shehajit. Ndërsa mandatin e demokratit tjetër, Edmond Spahos, në Elbasan pritet ta marrë Arben Elezi. Ambra Borova pritet të ulet në parlament në vendin e deputetit të LSI-së në qarkun e Shkodrës, Agron Çelës. Në këtë mënyrë, parlamenti të enjten do të shkojë në 99 deputetë. Me betimin e 3 të rinjve, numri i deputetëve në parlament do të shkojë në 99, ku 17 prej tyre janë të rinj, të ardhur nga listat e PD-së dhe LSI-së pas djegies së mandateve. Listave të kandidatëve po i vjen fundi në disa qarqe, çka do të sjellë përbërjen e Kuvendit me më pak se 140 deputetë. Në Kukës, Partia Demokratike nuk ka më kandidatë, pasi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka shpallur pazgjedhshmërinë edhe për të fundin në listë, Miftar Dautin. Gjithashtu, KQZ-ja ka shpallur pazgjedhshmërinë edhe për 10 kandidatë të tjerë në Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë. Ndërsa për LSI-në, dy kandidatë femra, njëra në Berat dhe tjetra në Tiranë nuk kanë dorëzuar formularin e deklarimit në KQZ. Në disa qarqe ka përfunduar lista e kandidatëve gra.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

### LISTA

Listave të kandidatëve po u vjen fundi në disa qarqe, çka do të sjellë përbërjen e Kuvendit me më pak se 140 deputetë. Në Kukës, PD-ja nuk ka më kandidatë, pasi KQZ-ja ka shpallur pazgjedhshmërinë edhe për të fundin në listë, Miftar Dautin. Gjithashtu, KQZ-ja ka shpallur pazgjedhshmërinë edhe për 10 kandidatë të tjerë në Gjirokastrë, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Tiranë.

### "Opozita të ofrojë alternativën e zgjidhjes"

## Mediu: Dialog me ndërkombëtarët, nuk ka zgjedhje me Ramën

Kreu i republikanëve, Fatmir Mediu, kërkoi angazhim më serioz të Partisë Demokratike për t'i bindur ndërkombëtarët për gjendjen e vështirë që sipas tij po kalon vendi. Sipas tij, në kushtet kur situata nuk është e qetë edhe vetë brenda Bashkimit Evropian, nuk mund të pritet që ata ta kuptojnë situatën në Shqipëri. "Mendoj se duhet një punë më të organizuar e opozitës në këtë drejtim. Ne nuk mund të rrimë të presim se do ta kuptojnë ose jo ndërkombëtarët dhe duke pasur në konsideratë faktin se ka probleme të jashtëzakonshme sot edhe përtej Atlantikut, por edhe në Europë, sidomos para zgjedhjeve parlamentare europiane, ne duhet të jemi shumë më këmbëngulës



për të negociuar dhe diskutuar jo vetëm thjesht problemin që ka Shqipëria, por edhe alternativën e zgjidhjes që duhet të ofrojmë si opozitë. Kjo është imediate dhe duhet të lëvizim sa më shpejt", tha kreu i PR-së për "Ora News". Mediu shprehet se ndërkombëtarët kanë një rol të rëndësishëm në politikën shqiptare. Mediu është i bindur

se zgjedhje me Edi Ramën kryeministër nuk do të ketë. Ai komentoi deklaratat e kryeministrit se pranon zgjedhje të parakohshme në qoftë se opozita merr një bashki me shumë se PS-ja. "Ku e gjen këtë besim? Është pikërisht kjo strukturë kriminale si në vendet e Amerikës Latine, të cilat në mënyrë të padiskutueshme nuk e kishin të forca e qeverisjes logjike kushtetuese, por të forca e krimit, pasasë së krimit dhe korrupsionit, që garantonte fitoren dhe blerjen e votave të qytetarëve në interes të një grupi të caktuar njerëzish", deklaroi ai. Qeveria, sipas Mediu, është kundër shqiptarëve, ndaj zgjidhja shprehet ai është vetë largimi i Ramës me çdo mjet të nevojshëm.

hapin e radhës që do të hedhë bashkë me të tjerë deputetë demokratë, që zënë karriget bosh të kolegëve të tyre dhe planet për ndry-



Seanca e fundit parlamentare

## Lista, Presidencë publikon kandidatët për gjyqtarë në Kushtetuese

Presidencë publikoi dje listën e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese. Bëhet fjalë për 13 emra, që duan të jenë pjesë e Kushtetueses. Presidencë informoi se lista me aplikantët së bashku me dokumentacionin e dorëzuar përcillen menjëherë pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi për verifikim dhe vlerësim sipas ligjit. Presidencë njoftoi se pas përfundimit të afatit të aplikimit për "Vendin vakant" gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e plotë kjo që krijohet më datë 25.05.2019, e shpallur me Dekretin nr. 11133, datë 04.03.2019, të Presidentit të Republikës, rezultoni se kanë aplikuar 13 kandidatë. Ata janë: Alban Brati, Arta Vorpsi, Avni Shehu, Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Ilir Mustafaj, Irena Reso, Kestrin Katro, Klodian Rado, Z. Kostandin Kazanxhi, Z. Mimsa Xhaferllari, Z. Nj. Mimoza Qinami, Z. Nj. Valbona Bala (Pajo).

### KANDIDATËT PËR VAKANCËN NË KUSHTETUESE

1. Z. Alban Brati
2. Znj. Arta Vorpsi
3. Z. Avni Shehu
4. Znj. Elsa Toska
5. Znj. Fiona Papajorgji
6. Z. Ilir Mustafaj
7. Znj. Irena Reso
8. Znj. Kestrin Katro
9. Z. Klodian Rado
10. Z. Kostandin Kazanxhi
11. Znj. Mimsa Xhaferllari
12. Znj. Mimoza Qinami
13. Znj. Valbona Bala (Pajo)

shimin e sistemit zgjedhor. "Me grupin parlamentar që do të krijohet, shumë shpejt, ndoshta të enjten bëhemi 7 nga PD-ja, se do të vijë edhe kryetari PD-së i Peqinit si deputet. Por, edhe me pjesën që kanë zëvendësuar listën e LSI, unë si Myslym Murrizi nuk e di sa do të më ecë fjala me përfaqësues të tjerë në Kuvend. Do ta kushtëzoj votën time në ndryshim të sistemit zgjedhor pasi Kodi është artificiel, ku të gjitha palët kanë dashur të fusin duart të votat. Komisionerët nuk duhet të jenë politikë dhe ka administratë që janë arsimit, pra mësues. Duhet të

ashpërsohet Kodi Penal për shpërblerjen e votës, si për shpërblerjen edhe blerësin", deklaroi z. Murrizi. Deputeti Murrizi shpjegon se ai dhe opozita e re do të ngulmojnë për listat e hapura: "Listat e hapura sjellin demokraci brenda subjekteve politike, vrasin servilizmin. Shkojnë para qytetarëve dhe vijën në emër të qytetarëve. Në ato karrige, ata që zgjidhen nga qytetarët. Listat e mbyllura kanë shtuar servilizmin, kanë nxitur orekset e kërmijve politikë për të monopolizuar karriget në atë parlament".

Zgjedhjet e qershorit, përfaqësuesit e BE-së në Tiranë takojnë Ramën e Metën



# Soreca thirrje për dialog: Kapërceni dallimet partiake

"Ka ende shumë punë për të bërë deri në qershor"

Valentina Madani

Një përfaqësi e 28 vendeve të BE-së ndodhen në Tiranë për të parë nga afër progresin e vendit tonë përpara zgjedhjeve lokale të 30 qershorit. Përfaqësues të 28 vendeve anëtare të vendeve të Bashkimit Evropian zhvilluan dje takime me presidentin Ilir Meta dhe kryeministrin Edi Rama. Ata ndodhen në Tiranë për të vëzhguar progresin përpara zgjedhjeve të qershorit, si një kriter për hapjen e negociatave. Në takim me ish-të ambasadori i BE-së në Tiranë Luigji Soreca, cili bëri thirrje për dialog mes partive politike për mbrojtjen e interesave të popullit tonë që dëshiron të vazhdojë rrugëtimin drejt BE-së. Në një postim në "Twitter" me rastin e vizitës së përfaqësuesve të vendeve të BE në Tiranë, Soreca shkruan se është bërë përparim i konsiderueshëm krahasuar me qershorin e kaluar, ndërsa shton se ka ende shumë për të bërë deri në qershor kur pritet dhe vlerësimi për Shqipërinë. "Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm nga qershori i kaluar, por ka ende shumë punë deri në qershor. Tani është koha për të kapërcyer dallimet partiake dhe për të dialoguar. Për të mbrojtur interesat e popullit shqiptar që dëshiron të vazhdojë rrugëtimin drejt BE-së", shkruan Soreca. Përfaqësues të 28 vendeve anëtare të vendeve të BE-së ndodhen në Tiranë për të vëzhguar progresin përpara zgjedhjeve të qershorit, si një kriter për hapjen e negociatave. Edhe para disa ditëve kreu i delegacionit të BE-së në Tiranë apeloj për dialog ndërkohë e quajti të gabuar vendimin e dorëzimit të mandateve. "Konsiderojmë se vendimi për heqjen dorë nga mandatet parlamentare pengon seriozisht funksionimin e demokracisë në Shqipëri dhe ndikon në integrimin e vendit në BE - një perspektivë që e duan plotësisht 93% e qytetarëve shqiptarë. Ne vazhdojmë të mbështesim ata që janë të angazhuar në procesin demokratik në Parlament, gjithashtu në mbrojtjen e interesave të popullsisë shqiptare që dëshiron të vazhdojë të ecë



Ambasadori i BE-së në Tiranë Luigji Soreca

**DEKLARATA**  
"Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm që nga qershori i kaluar. Ka ende punë për të bërë deri në qershorin e ardhshëm. Është me të vërtetë koha tani për të kapërcyer dallimet partiake dhe për të angazhuar në dialog. Për të mbrojtur interesat e popullit shqiptar që dëshiron të vazhdojë të lëvizë drejt BE-së", u shpreh ambasadori Soreca.

**SHKURTE**

**LSI: Dialog me ndërmjetësimin e Metës, por jo takim Rama-Basha**

Ish-deputeti i LSI-së Edmond Panariti deklaroi dje se palët politike mund të ulen për zgjidhjen e krizës vetëm me ndërmjetësimin, por jo me një takim të dytë Rama-Basha pasi herën e parë kjo praktikë rezultoi e dështuar. "Ne pranojmë një tryezë të presidentit, por jo një takim Rama-Basha, sepse herën e parë rezultoi i dështuar. E vetmja alternativë mbetet Presidenti i Republikës. Është përgjegjësi e kreu të shtetit për vendosur stabilitetin. Presidenti mund të mbajë pozicionin e tij dhe t'ua lërë në dorë palëve. Por koha po ikën. Pa dyshim që djegia e mandateve është një gjest ekstrem, po ishte refleksi i një situatë ekstreme. Kjo situatë nuk ka rikuperim, sepse mandatet janë të djegur. Nga ana e maxhorancës nuk pati keqardhje. Ata kanë dashur të na degradonin dhe ne nuk e lejuam këtë gjë, ikëm vetë", u shpreh ish-deputeti Panariti. Sipas tij ka ardhur koha që dy partitë opozitare të nënshkruajnë një marrëveshje zyrtare mes tyre.

**Bylykbashi-Ramës: Do përfundosh keq, jo vetëm politikisht!**

Ish-deputeti Oerd Bylykbashit, paralajmëroi dje kryeministrin Rama se nëse do ta ketë të keq fundin politike teksa i kujtoi se ka modele në histori që tregojnë që personazhe të tilla përfundojnë keq, jo vetëm politikisht. Tonet e forta sipas Bylykbashit justifikohen nga rrethanat që po shohin kryeministrin në trajt gjithmonë më shumë të spikatura të një "hiperautokrati, që e ndjen veten të fuqishëm, sepse ka gjithë institucionet, siç u pa në shesh". Bylykbashi e cilëson se në çështjen e financimit të PD-së, prokuroria po përdoret politikisht si instrument i qeverisë dhe kjo nuk e habit aspak. Alarmante, sipas tij, situata e sistemit të drejtësisë, sidomos pas "rënies të Gjykatës Kushtetuese" me një "prokurorë të përgjithshme të përkohshme që qëndron aty në mënyrë antikushetuese, 1 vit e 3 muaj dhe që fle mbi dosje që përbejnë korrupsion zgjedhor", dhe përmend këtu dosjet e famshme 339 dhe 184. Sipas tij, "po të ishin goditur këta që bëjnë krime zgjedhore sipas kodit penal të 2017, që miratuar me konsensus, ne sot do të kishim histori tjetër". Kriza politika, sipas tij, mund të njohë vetëm përshkallëzim, që njeh si zgjidhje vetëm zgjedhjet e parakohshme, "por pa Edi Ramën". Sistemi zgjedhor nuk ka rendësi, sipas tij sepse "të gjithë sistemet janë përfaqësuese". "Shqipëria i ka provuar të gjitha, mazhoritarin, gjermanin, paralelin, proporcionalin rajonal.

**Zgjedhjet, marrëveshja mes OSBE dhe policisë**

**OSBE: Policia të jetë asnjëse, t'i garantojë qytetarët se vota vlen**

Në prag të zgjedhjeve që pritet të mbahen me 30 qershor, Policia e Shtetit në bashkëpunim me OSBE-në ka nisur trajnimin për uniformat blu, për krijimin e kushteve të mbarëvajtjes së procesit. Ambasadori i OSBE Bernd Borchardt u shpreh se policia duhet të garantojë njerëzit për rezultatet përfundimtare dhe të thellohet më tej bashkëpunim me KQZ-në. Nga ana tjetër, drejtori i Policisë së Shtetit tha se prishmëria do të jetë e lartë për zbatimin e ligjit. "Megjithatë diskutimet politike kanë potencialin e ulët, se besimi publik në proceset themelore demokratike të organizimit të zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, unë jam i sigurt se sjellja profesionale e institucioneve publike, duke përfshirë edhe Policinë e Shtetit mund të shtojnë tek njerëzit garancinë se vota e tyre me të vërtetë është e vlefshme dhe se rezultatet përfundimtare pasqy-



ronjë vullnetin politik të të gjithë shoqërisë shqiptare. Policia e Shtetit do të jetë asnjëse në këtë proces kaq të rëndësishëm dhe do të sillte me profesionalizëm dhe dinjitet", tha z. Borchardt. Nga ana e tij, drejtori i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu përmendi se prishmëria do të jetë e lartë për zbatimin e ligjit, dhe se policia është aktori kryesor, i cili garanton ushtrimin e të drejtës së votës për të gjithë qytetarët shqiptarë. "Edhe

**DENONCIMI**  
PD përmes ish-deputetes Albana Vokshi denoncoi dje dështimin e qeverisë në ruajtjen e institucioneve dhe pse janë shpenzuar 101 milionë euro. Sipas saj kryeministri Rama i ka dhënë 34 milionë euro kompanive të sigurimit të Safet Gjiçit dhe deputetit Pjerin Ndreu.

për këto zgjedhje prishmëritë për veprimtarinë e Policisë së Shtetit do të jenë cilësisht në rritje dhe të orientuara drejt zbatimit korrekt të ligjit. Këtë qëllim i shërben dhe trajnimi i të gjithë punonjësve të Policisë së Shtetit, trajnimi i cili fillon sot me drejtuesit qendrorë dhe vendorë të Policisë së Shtetit e do të vijojë më pas me të gjithë punonjësit që do të përshihen në këtë proces", deklaroi z. Veliu.

drejt BE-së. Që prej qershorit të kaluar është bërë progres, veçanërisht në reformën në drejtësi, si dhe në luftën kundër krimin të organizuar, por ka ende shumë punë për të bërë në tre muajt e ardhshëm. Tani

është shumë urgjente që të kapërcehet situata politike aktuale duke krijuar një platformë kombëtare për dialog ndërmjet të gjitha palëve të interesuara, edhe duke pasur parasysh zgjedhjet e ardhshme lokale të qer-

shorit. Shqipëria ka nevojë për një dialog ndërpartiak për reformat më urgjente, duke përfshirë reformimin e kuadrit ligjor zgjedhor në përputhje me rekomandimet e OSBE / ODIHR-it", deklaroi ambasadori Soreca.

## DIPLOMACIA SHKARKIMET

Cakaj: Nuk përmbushin kushtet ligjore dhe ato minimale profesionale

# Valë spastrimesh në Ministrinë e Jashtme, largohen 20 diplomatë

"Shqipëria nuk është e miqve dhe e kushërinjve politikë"

Më shumë se 20 diplomatë që shërbenin në përfaqësitë tona diplomatike nëpër botë janë pushuar nga puna. Lajmin e bëri të ditur dje zëvendësministri i Evropës dhe Punëve të Jashtme, Gent Cakaj, në një konferencë të posaçme për shtyp, ku deklaroi se Shqipëria do të ndërpresë marrëdhëniet e saj me disa prej diplomatëve nëpër botë, që nuk përmbushin kushtet dhe cilësitë për të qenë në detyra të tilla. "Pas kësaj ndërmarrjeje të kujdesshme, sot unë jam me ju të ndaj faktin se kam vendosur të shkëpus marrëdhënien me një pjesë të punonjësve që nuk përmbushin as kushtet ligjore, as kushtet minimale profesionale për kryerjen e kësaj detyre, e lëre më pastaj mbështetur ambicien e kësaj qeverie e vizionin e kryeministrit për ta çuar në lartësinë e merituar përfaqësimin ndërkombëtar të Shqipërisë. Fillimisht ju informoj se numri i të prekurve nga kjo iniciativë reformatore do të shkojë mbi 20", - tha Cakaj. Gjithashtu, ai bëri të ditur se një grup punonjësish do të transferohen në detyra të tjera, kjo për të dhënë një impuls të ri punës së tyre. "Një pjesë tjetër e punonjësve do të transferohen menjëherë për të vepruar dhe punuar sipas nevojave reale të punës dhe jo sipas inercionit të së shkuarës", - shtoi Cakaj. Ai sqaroi se këto spastrime në radhët e diplomatëve është bërë jo në mënyrë rastësore dhe preferenciale, por duke u bazuar mbi një studim që një grup pune i ka bërë përgatitjes së tyre dhe performancës në detyrë. "Ambicia për një shërbim ekselent diplomatik e ka karakterizuar përkëqjen e zellsime të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme përgjatë të gjithë 5 viteve të fundit. Sidoqoftë, jetësimi i kësaj ambicije mbetet ende një sfidë e hapur. Në këto 77 ditë të punës sime në krye të këtij institucioni, unë kam mbledhur një grup të posaçëm pune për të shqyrtuar hollësisht cilësinë e burimeve njerëzore të shërbimit diplomatik të shtetit shqiptar", - u shpreh zëvendësministri i Jashtëm. Cakaj theksoi gjithashtu se detyra e diplomatit dhe përfaqësuesit të vendit tonë në marrëdhënie me ndërkombëtarët nuk "nuk përkon kurrësi me nepotizmin, klientelizmin politik dhe korrupsionin moral në asnjë sektor e lëre më pastaj në përfaqësitë e Shqipërisë nëpër botë. Ky proces - theksoi ai - do i hapë rrugë nga ana tjetër edhe emërimeve të denja dhe të merituar nga studentët e ekselencës, kjo edhe në zbatim të Paktit për Universitetin". Ndaj ai ftoi

gjitë të interesuarit për të aplikuar në vendet vakante në shërbimin diplomatik. "Duke vlerësuar njëkohë-

sisht momentin historik të hapjes së dyerve të shtetit për të rinjtë ekselentë të këtij vendi, si një avantazh

të madh që duhet shfrytëzuar me patjetër e doemos për të ripërtërirë në mënyrë thelbësore e përmbajtësore

administratën tonë, unë sot përpara jush komunikoj se ne kemi gati thirrjen publike për aplikimin e vakancave të krijuara nga kjo valë pastrimi në shërbimin tonë diplomatik. Shqipëria nuk është e miqve, nuk është e kushërinjve politikë, apo klaneve e krushqive të kujtdo goftë, por është e të gjithëve pa dallim dhe meriton të përfaqësohet nga më të dalluarit, që punojnë me mendje, vepronë me shpirt e shërbejnë me pasion, me kapacitetin e plotë profesional dhe moral", - tha Cakaj.



Zëvendësministri i Evropës dhe Punëve të Jashtme, Gent Cakaj



Kryeministri Edi Rama gjatë një mbledhjeje qeverie me ministrat

### THIRRJA

"Unë sot përpara jush komunikoj se ne kemi gati thirrjen publike për aplikimin e vakancave të krijuara nga kjo valë pastrimi në shërbimin tonë diplomatik".



PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Njofton se duke filluar nga data 27 Mars 2019 çmimi maksimal i shitjes me pakicë për 1 paketë për produktet e mëposhtme është si vijon:

Përshkrimi i Produktit	Çmimi prej datës 27.03.2019 (përfshirë TVSH-në)
MARLBORO PREMIUM BLACK KS BOS 20	500 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS LCB 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO GOLD (2.0 ORIGINAL) KS BOX 10	160 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO (RED FWD) KS BOX 10	160 Lekë/paketë
MARLBORO FLAVOR PLUS (FWD) KS SRP 20	320 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (4 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH (6 MG) KS RCB 20 SLI	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.0) 100 RCB 20 XSL	300 Lekë/paketë
MARLBORO TOUCH XL (2.5) 100 DSP 20 SSL	280 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS BOX 20	260 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS QUANTUM SUPREME KS RCB 10	130 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS SLIMSMAG 100 RCB 20 XSL	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC6M KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
PHILIP MORRIS COMPAC4 KS RCB 20 SLIMS	240 Lekë/paketë
MERIT BIANCA 100 BOX 20 SSL	220 Lekë/paketë
MERIT (ORANGE) KS RCB 20	230 Lekë/paketë
L&M RED LABEL KS RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 4MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOFT 6MG RCB 20	220 Lekë/paketë
L&M LOUNGE (6MG) 100 DSP 20 SSL	200 Lekë/paketë

Njoftimi bëhet në përputhje me Udhëzimin nr. 2, datë 28.1.2010 të Ministrisë së Financave "Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 17, datë 13.5.2008 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar" (i ndryshuar).

PHILIP MORRIS ALBANIA Shpk

Rr. Murat Toptani , Qendra e biznesit Eurocol, Kati i 10,  
1000 Tirana, Albania  
Tel: +355 42 276 670

### SHKURTE

## Shehu: Cakaj po vendos në terror trupin tonë diplomatik

Pas deklaratës së zëvendësministrit të Jashtëm, Gent Cakaj, ka ardhur edhe reagimi i opozitës. Ish-ministri i Jashtëm demokrat, Tritan Shehu, akuzoi Gent Cakajn se po vendos nën terror trupin tonë diplomatik. Përmes një postimi në "Facebook", Shehu shkruan se në mënyrë antikushutuese dhe antiligjore Cakaj po përdor një valë spastrimesh dhe transferimesh. Shehu shprehet se Cakaj është shndërruar në një instrument të verbër dhe shkatërrues i Ramës për të terrorizuar diplomacinë shqiptare. "Kryeministri e ministri i Jashtëm sot po luajn rolin e Ponc Pilatit. Ndërsa zv.ministri i Jashtëm, Cakaj, po vendos nën terror trupin tonë diplomatik. E ngjashme ajo që po ndodh sot në Ministrinë tonë të Jashtme me raprezaljet e vitit 1945. Krejtësisht antikushutuese, antiligjore dhe e pa precedentë që prej vitit 1991, kjo valë spastrimesh e transferimesh", siç e quan Cakaj me një gjuhë marksishte e arrogante dhunimin e atij dikasteri të nderuar, pavarësisht ndonjë emri të hedhur për justifikim", - shkroi Shehu. Më tej, ai shprehet se largimet kolektive nga puna janë veprime antiligjore.

## Ministria e Jashtme: Cakaj, ministër në detyrë

Unë, i nënshkruari Edi Rama në funksionin e kryeministrit dhe ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme ia delegoj kompetencat e mia për përfaqësimin në institucionet ndërkombëtare, zëvendësministrit Gent Cakaj", - kjo ishte deklarata që kryeministri Rama bëri, duke i kaluar kompetencat e drejtit të diplomacisë shqiptare Gent Cakajt gati dy muaj më parë. Por, ndonëse në këtë delegim kompetencash nuk flitet askund për emërtimin "ministër në detyrë", vetë Ministria e Jashtme e konsideron atë të tillë edhe në komunikimin zyrtar. Siç shihet nga publikimet në faqe, Cakaj kudo cilësohet ministër i Evropës dhe Punëve të Jashtme në detyrë.



### PROJEKTILIGJI

#### ■ NENI 15

Aplikimi dhe përfitimimi i ndihmës ekonomike

1. Kërkesa për të përfitur ndihmë ekonomike bëhet nga: a) kryetari i familjes ose njëri nga anëtarët madhorë të familjes së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm kur nuk ka bashkëshort/e;

b) secili prej bashkëshortëve, në rastet kur ata janë në proces zgjidhjeje martesë dhe nuk ka ende vendim gjykatë të formës së prerë.

2. Aplikimi për të përfitur ndihmë ekonomike bëhet tek administratori shoqëror në njësinë administrative nën juridiksionin e së cilës ka vendbanimin.

Kriteret, procedura dhe dokumentacioni për përfitimimin e ndihmës ekonomike, si dhe masa e përfitimimit të saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Pranueshmëria në skemën e ndihmës ekonomike mban parasysh gjendjen e varfërisë, të cilat vlerësohen bashkërisht, duke u dhënë peshë specifike të qarta, objektive e transparente, si pjesë e një formule të pikëzuar. Treguesit e vlerësimit të formulës së unifikuar të pikëzimit për përfitimimin e ndihmës ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ndihma ekonomike shpërndahet një herë në muaj nga Bashkia nëpërmjet shërbimit bankar dhe/ose shërbimit postar, bazuar në vendimin e Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

5. Të drejtën për ta tërhequr dhe marrë në dorëzim ndihmën ekonomike për familjet në nevojë e ka bashkëshortja e kryefamiljarit. Për rastet kur në strukturën e familjes bashkëshortja mungon, të drejtën e tërheqjes e ka kryetari i familjes.

Miratimi i listave të përfituesve, nuk bëhet më në këshill bashkiak

# Drafti, ndryshon skema e ndihmës ekonomike dhe pagesës së PAK

## Pagesa e PAK nuk ndërpritet kur punësohesh

Ndryshon skema e përfitimimit dhe dhënies së ndihmës ekonomike, pagesës së PAK dhe bonusit të bebes. Ministria e Shëndetësisë ka hartuar një projektligj krejtësisht të ri "Për Asistencën Socialiste" nëpërmjet të cilit kërkon të rregullojë mënyrën e dhënies së ndihmës ekonomike, pagesave të aftësisë së kufizuar dhe bonusit të bebes, si dhe thjeshtimin e procedurave të panevojshme për shkak të riorganizimit të skemës, të cilat janë bërë shpesh pengesë për mospërfitimimin në kohë të ndihmës ekonomike.

### NDIHMA EKONOMIKE

Në nenin 11 të ligjit përcaktohet përfitimimi i ndihmës ekonomike si një pagesë e kufizuar në kohë. Ky kufizim kohor do të synojë integrimin në jetën shoqërore të familjeve në skemën e ndihmës nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit, me qëllim që kjo skemë të mos përdoret si mekanizim përfitimimi që mund të çojë në papunësi të zgjatur të anëtarëve të familjeve në skemën e ndihmës ekonomike. Ndërsa në nenin 14 përcaktohet se masa e ndihmës ekonomike është e plotë për familjet pa të ardhura apo me të ardhura të pamjaftueshme nga programet e asistencës sociale, remitanca, qiraja, asetat, bujqësia apo të ardhura



Foto ilustruese

të tjera. Skema e re e ndihmës ekonomike nuk ka kriteret përjashtuese nga aplikimi për ndihmë ekonomike dhe çdokush mund të aplikojë përmes një procedure të thjeshtuar dhe pa dokumentacion të tepërt. Kjo dispozitë parashikon edhe rastet që përjashtohen nga skema e ndihmës ekonomike. Kështu përjashtohen nga përfitimimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë gjashtë mujore, familjet kryejnë ndarje të qëllimshme të anëtarëve të saj, nuk tërheq ndihmë ekonomike pa shkaqe të arsyeshme, brenda afateve të përcaktuara,

fshih informacionin apo kryen deklarim të rremë, si dhe refuzojnë përfshirjen në kurset e formimit profesional apo nuk rezultojnë punëkërkuar të papunë pranë zyrave të punës. Ndërkohë që përjashtohen nga përfitimimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë një vjeçare familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që është në moshë aktive pune dhe refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, apo që punësohet dhe ndërpret marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, si dhe ka kryer dy ose


### PËRJASHTIMI

Përjashtohen nga përfitimimi i ndihmës ekonomike, për një periudhë njëvjeçare familjet, të cilat kanë në përbërje të tyre qoftë edhe një anëtar të vetëm që është në moshë aktive pune dhe refuzojnë ofertat e përshtatshme për punë të zyrave të punës, apo që punësohet dhe ndërpret marrëdhëniet e punës pa shkaqe të arsyeshme, si dhe ka kryer dy ose më shumë deklarime të rreme.

më shumë deklarime të rreme.

### PAK

Në nenin 12 përcaktohet e drejta e përfitimimit të pagesës së aftësisë së kufizuar, e cila garantohet si një e drejtë që edhe në rastet e punësimit të personit me aftësi të kufizuara, përfitohet deri në 4 vite krahas pagës. Gjithashtu, projektligji parashikon edhe procedurën e përfitimimit të aftësisë së kufizuar dhe dhënja e këtyre përfitimimeve në bazë të vendimit të komisionit të vlerësimit, duke shmangur vendimin e këshillit bashkiak.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 6,800,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Sigurimi i pronës për disa objekte të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, deri më datë 23 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BANKA E SHQIPERISE**  
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT  
SEKTORI I PROKURIMIT

**TENDER I HAPUR KOMBËTAR**

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3,400,000 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halli", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë  
BIC: STANALTR  
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përkshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të sistemit të kondicionimit në godinën qendrore të Bankës së Shqipërisë, për një periudhë një vjeçare"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, deri më datë 18 Prill 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

**Komunikimi i bankës qendrore**

**Guvernatori mban prezantim në takimin e Stambollit**

Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, mori pjesë në takimin e Klubit të Guvernatorëve të vendeve të Azisë Qendrore, rajonit të Detit të Zi dhe Ballkanit, i zhvilluar në Stamboll. Guvernatori Sejko mbajti një prezantim në panelin me temë "Komunikimi i bankës qendrore për rritjen e efekshmërisë së politikave: forcimi i njohurive dhe ndërtimi i besimit". Gjatë prezantimit, ai theksoi se ndërtimi i besimit të publikut tek institucioni i bankës qendrore është një proces i gjatë dhe i vështirë, por rritja e transparencës dhe komunikimi i vazhdueshëm janë faktorë kyç për suksesin e

**POLITIKA**

Një element i rëndësishëm, i cili tashmë është kthyer në një nga përgjegjësitë e bankave qendrore është dhe edukimi financiar i publikut. Sipas Guvernatorit, Banka e Shqipërisë prej vitesh përqipet të shpjegojë arsyet që qëndrojnë pas vendimmarrjes së saj, nëpërmjet një sërë programesh edukuese, të cilat janë përshtatur sipas nevojave për informacion të grupeve të ndryshme të interesit.

Guvernatori shpjegoi objektivat, parimet dhe kanalet kryesore mbi të cilat Banka e Shqipërisë mbështet komunikimin me publikun, duke u kujdesur mbi të gjitha që informacioni të jepet në kohë dhe të jetë sa më i thjeshtë dhe i qartë. Një element i rëndësishëm, i cili tashmë është kthyer në një nga përgjegjësitë e bankave qendrore është dhe edukimi financiar i publikut. Sipas Guvernatorit, Banka e Shqipërisë prej vitesh përqipet të shpjegojë arsyet që qën-



drojnë pas vendimmarrjes së saj, nëpërmjet një sërë programesh edukuese, të cilat janë përshtatur sipas nevojave për informacion të grupeve të ndryshme të interes-

it. Këto përpjekje kanë si qëllim afatgjatë, krijimin e një shoqërie që kupton, reagon e krijon pritshmëri në përputhje me vendimmarrjen e Bankës së Shqipërisë.

këtij procesi. Guvernatori Sejko, përmes ilustrimit me shembuj konkretë, ndau me të pranishmit eksperiencën e Bankës së Shqipërisë në komunikimin e politikës

monetare dhe politikave të tjera të saj, të cilat ndihmojnë në ruajtjen e stabilitetit makroekonomik të vendit dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve shqiptarë.

Keri: Certifikohet "Air Albania", pesë aeroportet ku do të operojë

**Drejtori i Aviacionit Civil: Çmime më të lira biletash**

*Fluturimet do të nisin me destinacion aeroportin e ri të Stambollit*

"Air Albania" do të fillojë fluturimet në mes të muajit prill, me nisjen e operimit të aeroportit të ri të Stambollit. Kreu i Autoritetit të Aviacionit Civil, Krislen Keri bëri me dije se dikasteri që ai drejton ka përmbyllur certifikimin, ndërkohë që çmimi i biletave për qytetarët pritet të jetë më i lirë. Fillimisht, "Air Albania" do të kryejë fluturimet drejt Stambollit, ndërsa më pas do të zgjerohet edhe në 4 aeroporte të tjera.

**CERTIFIKATA**

"Air Albania" ka marrë certifikimet e nevojshme pranë Autoritetit të Aviacionit Civil sipas kërkesave të kuadrit ligjor vendës dhe direktivave të Bashkimit Europian. Gjatë një konference për shtyp, Krislen Keri, drejtor i Përgjithshëm i Autoritetit të Aviacionit Civil bëri me dije edhe detajet, duke theksuar se tashmë avioni i parë i linjës ajrore "Air Albania" është regjistruar nën emërtimin A319 Za Bel në regjistrin e avionëve civilë. Ai bëri me dije po kështu se është miratuar pjesa e stafit prej 38 punonjësish dhe tetë pilotësh të kompanisë. Kodi që do të mbajë avioni është ABN. Mirëmbajtja e avionëve do të bëhet nga pjesa teknike e kompanisë "Turkish", që është edhe aksionere, ndërkohë që kompania shqiptare do të atashohet pranë organizatës së trajnimit të "Turkish Airlines". Fluturimet e kompanisë pritet të nisin në mes të prillit. "Fluturimet do të nisin me destinacion aeroportin e ri të Stambollit, ndërkohë që kompania "Air Albania" ka njoftuar se është në pritje të avionit të dytë, që do të ketë si synim destinacionet në aeroportet europiane. Ne duam të bëjmë përgatitjet për avionin e ri, i cili do të ketë destinacionet e reja në aeroportet europiane. Tri aeroporte në Itali, ku bëjnë



Kreu i Autoritetit të Aviacionit Civil, Krislen Keri

pjesë Roma, Milano dhe Bolonja si dhe aeroportin i Londrës. Futja e "Air Albania" ka sy aspekte pozitive, ku e para synohet që të ketë ulje të çmimit të biletave, pasi ofrohet një alternativë më shumë dhe më e lirë, si dhe prezencën e Shqipërisë në një treg dhe destinacione ku ka shqiptarë", tha Keri. Tashmë, kompania duhet të vijojë me licencimin pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**KRIJIMI I "AIR ALBANIA" DHE AKSIONERËT**

Në 16 qershor të vitit të shkuar, qeveria përcaktoi për herë të parë procedurat për krijimin e shoqërisë "Air Albania", e cila do të operojë në fushën e transportit ajror. Tre ortakët e saj, sipas të njëjtit vendim janë "Albcontrol", sh.a., që përfaqëson palën shtetërore shqiptare dhe dy subjekte të tjera, "Turkish Airlines"

dhe "MDN Investment", sh.p.k. Kompania u regjistrua në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më 13 shtator, ku qartësohet edhe pjesa e

aksioneve që zotëronte secila palë. Kështu, "Albcontrol" zotëron 10 për qind të aksioneve, 41 për qind "MDN Investment" dhe "Turk Hava

Yollari A.O" 49 për qind. "Air Albania" është cilësuar në deklaratat e kryeministrit si një linjë që do të ofrojë çmime 'low cost' për disa destinacione, ku i pari do të jetë Stambollit. Në një dokument të Autoritetit të Konkurrencës të pak kohëve më parë, ku bëhej edhe vlerësimi i përgjendrimi, bëhej e ditur se destinacionet e tjera pas Stambollit do të jenë Roma, Bolonja dhe Londra. Në mes të shkurtit të këtij viti u njoftua nënshkrimi marrëveshjes trepalëshe financiare mes aksionerëve të kompanisë, ndërkohë që u bë me dije se kompania ishte në procesin e përbushjes së disa kërkesave teknike dhe hartimi dokumentesh si një hap që do të sillte certifikimin.

**Artan Lame emërohet në krye të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**

Artan Lame emërohet në krye të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, institucioni i ri që bashkon ALUIZINI-n dhe Hipotekën. Kryeministri Edi Rama ka urdhëruar emërimin e Lames drejtor të përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe vendimi është firmosur të hënën. Ligji i ri "Për Kadastrën" hyri në fuqi pak kohë më parë dhe së shpejti pritet të ngrihet edhe struktura e re. Agjencia e Kadastrës do të jetë në



vartësi të kryeministrit dhe institucioni shihet si themeli i reformës së pronës. Ligji i miratuar pak muaj më parë shkrin disa agjenci duke i bashkuar në një. Sipas ligjit të ri që tashmë ka hyrë në fuqi,

Agjencia e Legalizimeve, ajo e Kompensimit të ish-Pronarëve dhe ajo e Hipotekave do të shkrihen për t'u bashkuar nën çatinë e një institucioni, Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, që do të jetë në varësi direkte të kryeministrit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës do të ketë Drejtorinë e Përgjithshme në Tiranë dhe drejtori e zyra varësisë në nivel vendor, tekta organizimi dhe numri i strukturave të varësisë përcaktohen nga kryeministri me propozim të Këshillit Drejtues.

**TË ARDHURAT**



Remitancat, 285 milionë euro vitin e kaluar

Të ardhurat e shqiptarëve nga puna jashtë vendit arritën vlerën e 285 milionë eurove vitin e kaluar. Kjo shumë përfshin të ardhurat nga punësimi sezonal i shqiptarëve jashtë vendit, ose nga puna në formën e shërbimeve 'outsourcing', që shqiptarët kryejnë për subjekte që ndodhen jashtë Shqipërisë. Mbështetur në të dhënat e Bankës së Shqipërisë, këto të ardhura u rritën me 8% për vitin 2018 dhe po bëhen një burim gjithnjë e më i rëndësishëm për ekonominë shqiptare. Këto shifra dëshmojnë se të ardhurat nga jashtë tashmë nuk lidhen vetëm me remitancat dhe emigracionin e përhershëm. Shqiptarët po kërkojnë mundësi punësimi jashtë, goftë në mënyrë të përkohshme apo edhe duke punuar nga Shqipëria. Për një ekonomi me një bilanc tregtar deficitar si ajo shqiptare, gjetja e mënyrave për të ngushtuar këtë deficit nëlet e rëndësishme. Deri tani, format kryesore që e kanë ngushtuar deficitin e llogarisë korrente kanë qenë remitancat, turizmi, sektori fason dhe eksportet e shërbimeve në përgjithësi. Dërgesat e emigrantëve u rritën edhe për vitin e kaluar në 670 milionë euro, 5% më shumë krahasuar me vitin 2017. Palë valës së dytë të emigrimit, remitancat kanë nisur një fazë të re rritjeje, por sidoqoftë janë larg niveleve maksimale që patën arritur në mesin e viteve 2000.

Agjencia e Trajtimit të Pronave çel procedurat për dorëzimin e 8 dokumenteve

# ATP: 300 pronarët që marrin kompensimin

*Përfituesit në Tiranë, Durrës, Vlorë, Elbasan*

Agjencia e Trajtimit të Pronave hap procedurat për kompensimin e 300 pronarëve, që u është zënë toka nga ndërtime pa leje. Përmes një njoftimi për mediat, ATP-ja bën të ditur se nis procesin e pranimit të kërkesave për kompensimin e pronarëve të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtime informale, gjeneralitetet dhe të dhënat e të cilëve

janë sipas VKM-së Nr.125, datë 13.03.2019. "Procesi i pranimit të kërkesave të subjekteve përfituesve do të fillojë në datën 01.04.2019 dhe nuk do të jetë i kushtëzuar dhe i kufizuar në kohë. ATP-ja fton të gjitha subjektet e interesuara të paraqiten pranë zyrave të saj, në adresën rruga 'Muhamet Gjollështa', nr. 54, Tiranë, çdo ditë nga e hëna në të

premtë, për plotësimin e kërkesës për kompensim dhe dorëzimin e dokumenteve përkatëse. Subjekti kërkuar është (subjekti përfitues/trashëgimtar i ligjor/përfaqësuesi me prokurë), në momentin e plotësimit të kërkesës për kompensim", - thuhet në njoftimin e ATP-së.

### PËRFITUESIT

Pronarët përfitojnë një fond rreth 50 milionë

lekë dhe iu kompensohet një sipërfaqe e përgjithshme prej rreth 11 866,63 m<sup>2</sup>. Përfituesit janë në Berat, Elbasan, Peqin, Librazhd, Gramsh, Durrës, Tiranë, Fier, Lushnjë, Shkodër, Korçë, Pogradec, Lezhë, Vlorë, Sarandë, Gjirokastrë, Përmet, Kavajë dhe Kukës. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë të përfituesve.

### DOKUMENTET

1. Kërkesa për kompensimin e pronës, sipas formatit-tip, që vihet në dispozicion nga ATP-ja.
2. Dëshmia e trashëgimisë për të gjithë trashëgimtarët e ligjshëm të subjektit përfitues, sipas radhës së trashëgimtarëve, në përpunje me përcaktimet e Kodit Civil.
3. Prokura e posaçme, e nënshkruar nga të gjitha subjektet që përfitojnë kompensim, ku si tagër i nevojshëm të jetë edhe e drejta për të tërhequr vlerën financiare në emër të tyre. (Në rastet kur nuk është e mundur të dorëzohet prokura e posaçme, secili bashkëpronar apo një pjesë e tyre paraqesin kërkesë individuale apo të përbashkët për pjesën e tyre në pronën që kompensohet. Në rastin e kërkesave individuale të secilit bashkëpronar apo të një pjesë të tyre, për çdo kërkesë të kryer paguhet tarifë shërbimi në vlerën 2 000 (dymijë) lekë, pavarësisht se i përket të njëjtës pasuri të paluajtshme).
4. Vërtetimi original i lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë për hapjen e llogarisë bankare në emër dhe për llogari të subjektit përfitues, ku përcaktohet edhe numri i llogarisë bankare (IBAN), ku do të transferohet vlera financiare e përfutur.
5. Fotokopja e dokumentit të identifikimit.
6. Mandatpagesa që vërteton pagimin e tarifës së shërbimit në vlerën 2 000 lekë.

### PRONARËT QË MARRIN KOMPENSIMIN

Emër	Atësi	Mblëmër	NADIRE	BAJRAM	MOLLOHOLLI	REXHEP	CULLHAJ	DRITA	SHABA
YMER	REXHEP	PENI	FATBARDHA	ABDYL	LOLJA	SADETE	CAUSHI	ENVER	RADA
DEMIR	REXHEP	PENI	HYSEN	ABDYL	MOLLOHOLLI	SERVETE	KECI	LULZIM	HOXHA
BEKIM		SHYTI	ESMERALDA	ABDYL	MOLLOHOLLI	SHERIF	CULLHAJ	ALFRED	SHABA
MUHAMET		SHTALBI	MEDIHA	OSMAN	(PULLAZI)	SULLTANA	SHIMA	EDMOND	SHABA
DRITA	MUHAMET	RAMA	BESNIK	OSMAN	PULLAZI	VJOLLCA	TROPLINI	BAKUSHE	REXHEP
ESHREF	MUHAMET	SHTALBI	PETRIT	OSMAN	PULLAZI	GANI	AGA	MUHAREM	REXHEP
ISMAIL	MUHAMET	SHALBI	ARBEN	OSMAN	PULLAZI	AGIM	MUHARREM	QELEPOSHI	RADA
LUAN	HAKI	HASEQIU	AGIM	OSMAN	PULLAZI	ASTRIT	HAMDI	BILALAJ	PRANVERA
FATMIR	HAKI	HASEQIU	MEREME	OSMAN	PULLAZI	VALDET	HAMDI	BILALAJ	JUSUF
SHAHU	HAKI	HASEQIU	MEDIHA	OSMAN	(PULLAZI)	ASTRIT	HAMDI	BILALAJ	SULLTANE
VJOLLCA	SHEFQET	HASEQIU	BESNIK	OSMAN	PULLAZI	INXHI	RIZA	KURA	BUKURIE
KLEVIN	FERDINAND	HASEQIU	PETRIT	OSMAN	PULLAZI	VALENTINA	HEKURAN	BARXHA	NEXHMIJE
ENEA	FERDINAND	HASEQIU	PETRIT	OSMAN	PULLAZI	PETRIT	HEKURAN	KURA	MARJANA
IBRAHIM		TOPTANI	ARBEN	OSMAN	PULLAZI	LUMTURI	HEKURAN	ALIU	LEJLA
LILJANA	SHERIF	SHTINO	AGIM	OSMAN	PULLAZI	SHQIPONJA	HEKURAN	KURE	MERITA
ILONA	VASIF	ZISO	MEREME	OSMAN	PULLAZI	MENEKSHE	HEKURAN	FECANJI	ARBEN
VIVIANA	PETRIT	TOPTANI	ADEM	MUHARREM	JOCA	FLORA	HEKURAN	SANXHAKU	SILVANA
QAMIL	HYSEN	BIÇAKU	MAHMUDIJE	MUHARREM	JOCA	ARDI	VELEDIN	KURE	CAJE
GJINOVEFA	MUSTAFA	BIÇAKU	IBRAHIM	CULLHAJ	SHIMA	KRISTEL	VELEDIN	KURE	IBRAHIM
NERAIDA	HYSEN	TAUSHANI	SULLTANE	SHIMA	CULLHAJ	FESTIM	BANUSH	IBRALIU	MYSLYM
LUM-MIR	SHERIF	FRASHERI	IDRIZ	CULLHAJ	CULLHAJ	BESNIK	HASAN	HYSENBELLI	HAVA
RITA	SHERIF	FRASHERI	REXHEP	CULLHAJ	CULLHAJ	FETAH	ASLLAN	FERATI	HAXHIRE
AHMET SHYQËRI	DERVISH	BIÇAKU	SHERIF	CULLHAJ	CULLHAJ	BESNIK	ASLLAN	FERATI	HYSNY
EVELINA	PETRIT	QYQJA	LUTFI	CULLHAJ	CULLHAJ	AFERDITA	YMER	TRESA	ILIRJAN
SEFEDIN	SHYRI	BIÇAKÇIU	SHERIF	CULLHAJ	CULLHAJ	BAJAME	YMER	TRESA	SHERIF
REFIK	PETRIT	TOPTANI	EMINE	CULLHAJ	CULLHAJ	FATOS	YMER	GJATA	BAHKIM
GJINOVEFA	MUSTAFA	BIÇAKU	FATIME	CAUSHI	CAUSHI	FLAMUR	YMER	GJATA	FADIL
QAMIL	HYSEN	BIÇAKU	SADETE	CULLHAJ	CULLHAJ	ISLAM	YMER	GJATA	VELI
NERAIDA	HYSEN	TAUSHANI	HURMA	CULLHAJ	CULLHAJ	LAJE	YMER	ALLA	XHEMAL
DERVISH BIÇAKU	MEHMET	SEBAUDIN	VAJE	CULLHAJ	CULLHAJ	RAMAZAN	YMER	KODRA	HAMIT
ILONA	VASIF	ZISO	RAMAZAN	CULLHAJ	CULLHAJ	LILJANA	YMER	KODRA	ALLA
VIVIANA	PETRIT	TOPTANI	REFIK	CULLHAJ	CULLHAJ	LILJANA	YMER	KODRA	NAIM
EVELINA	PETRIT	QYQJA	GEZIM	CULLHAJ	CULLHAJ	MIMOZA	YMER	KRASNICA	NAIM
IBRAHIM		TOPTANI	SERVETE	KECI	ADELINA	ASTRIT	YMER	HASA	FADIL
SEFEDIN	SHYRI	BIÇAKU	SANIJE	CULLHAJ	CULLHAJ	NADIRE	YMER	HASA	MYSLYM
LUM-MIR	SHERIF	FRASHERI	SHKRETA	CULLHAJ	CULLHAJ	ADELINA	BODLLI	GANI	GANI
LILJANA	SHERIF	SHTINO	ZONJE	CULLHAJ	CULLHAJ	AIDA	BODLLI	XHEMAL	XHEMAL
RITA	SHERIF	FRASHERI	ZONJE	CULLHAJ	CULLHAJ	ARTAN	BODLLI	HAZIZ	HAZIZ
ERMIRA	SHAQIR	LLATJA	SHPRESA	CULLHAJ	CULLHAJ	BUKURIE	BODLLI	Androniqi	QAZIM
BOIKEN	ARDIAN	LEKA	FLUTURA	CULLHAJ	CULLHAJ	RAMAZAN	BODLLI	Stavrulla	Jorgji
FLORIANA	ARDIAN	LEKA	KUJTIM	CULLHAJ	CULLHAJ	ALLAMAN	BODLLI	Jorgji	Jorgji
TRITAN	MIRDASH	KALO	MIMOZA	CULLHAJ	CULLHAJ	RAMAZAN	BODLLI	Aleksandra	Jorgji
LULZIM MIRDASH	MOLLOHOLLI		ASTRIT	CULLHAJ	CULLHAJ	SHKELQIM	BODLLI	Janulla	Jorgji
SPARTAK	XHAFERR	BAKLLAMAJA	MIRELA	CULLHAJ	CULLHAJ	DHIMITRAQ	BODLLI	Garufo	Kapurani
ISAVETA	QAMIL	LEQEJZA	BARDHA	CULLHAJ	CULLHAJ	BEDRI	BODLLI	Marina	Vasilii
MIGEN	RITVAN	GAJDA	HANE	CULLHAJ	CULLHAJ	LUMTURI	BODLLI	Camato	Qosa
ALFRED	QAMIL	MUZHAQI	ARBEN	CULLHAJ	CULLHAJ	ISUF	BODLLI	Fotino	Muka
DASHAMIRA	QAMIL	CENGELI	BAJRAM	CULLHAJ	CULLHAJ	ISUF	BODLLI	Foto	Papa
FLORIKA			EMINE	CULLHAJ	CULLHAJ	ISUF	BODLLI	AHMET	Hasimi
GENC	ALI	MOLLOHOLLI	FATIME	MANÇAKU	MANÇAKU	RAZIJE	BODLLI	EDLIRA	HASAN
LOLITA	ALI	BUSHATI	GEZIM	CULLHAJ	CULLHAJ	FATBARDHA	BODLLI	(SIJONI)	HAXHIA
			IBRAHIM	CULLHAJ	CULLHAJ	ALTIN	BODLLI	IDAJETE	KUTA
			IDRIZ	CULLHAJ	CULLHAJ	SHABAN	BODLLI	(SIJONI)	KORRIKU
			LUTFI	CULLHAJ	CULLHAJ	LAVDIM	BODLLI	MYZEJEN	BAXHAKU (SIJONI)
			RAMAZAN	CULLHAJ	CULLHAJ	XHEVDET	BODLLI	RUZHDI	SIJONI
			REFIK	CULLHAJ	CULLHAJ	DALLENDYSHE	BODLLI	SHYQYRI	SIJONI

Ekzekutimi i "menaxherit të VIP-ave", dyshohet për vrasje me pagesë. Në kërkim një i katërt

# Vrasja e Jurgen Kurtit, pranga 3 të rinjve

*Policia: Arrestuam autorët, sekuestruam armë dhe dy makina luksoze*

**P**olicia e Shtetit ka zbardhur ngjarjen, ku mbeti i vrarë Jurgen Kurti me 18 mars në rrugën "Zef Jubani" në Tiranë. Shtetasit e arrestuar si të dyshuar për vrasjen e Jurgen Kurti janë identifikuar si Elsi Levendi, Olsi Qalliaj dhe Alesio Berberi.



Viktima Jurgen Kurti

Gjithashtu, janë sekuestruar në cilësinë e provës materiale një armë zjarri "Pistoletë TT", fishekë luftarakë, një automjet që u ka shërbyer autorëve për t'u larguar pas kryerjes së ngjarjes si dhe një sasi e vogël lëndë narkotike, 2470 euro e lekë shqiptare si dhe dy makina të tjera luksoze. Ndërkohë vijon puna intensive për të bërë të mundur dokumentimin e plotë me prova ligjore të personave të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje si dhe për dokumentimin e motiveve, të cilat çuan deri në atentatin, ku mbeti i vdekur Jurgen Kurti apo siç njihet ndryshe si "menaxheri i VIP-ve".

**DYSHIMET MBI MOTIVIN**

Policia e Tiranës nuk ka ende një motiv për ngjarjen, ndërsa të arrestuarit rezultojnë të papunë dhe dyshimet shtohen se ata mund të jenë të përfshirë në shpërndarje të lëndëve narkotike. Nga ana tjetër, një tjetër pistë, e cila mund të qëndrojë është fakti se vrasja mund të jetë kryer edhe me pagesë.

armë zjarri "Pistoletë TT", fishekë luftarak, një sasi prej 2470 Euro e lekë shqiptare, 13 aparate celular, si dhe një sasi e vogël lëndë narkotike. Veprimet hetimore janë në vazhdim e sipër për të bërë të mundur

dokumentimin e plotë me prova ligjore të personave të tjerë të përfshirë në këtë ngjarje, si dhe për dokumentimin e motiveve të kësaj ngjarje. Për arsye hetimore nuk bëjmë me dije të dhëna të tjera pasi cenojnë

hetimin.

Materialet iu dërguan Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Tiranë, për veprat penale "Vrasje me paramendim e kryer në bashkëpunim", "Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarakë", "Prodhim dhe shpërndarje të lëndëve narkotike", njofton policia.

**HETIMET**

Katër personat e përfshirë në vrasjen e Jurgen Kurtit janë miq me njëri-tjetrin. Tre të arrestuarit kanë thënë se nuk kanë pasur njohje me herët me viktimitin. Gazetarja e "BalkanWeb" Dorjana Bezat raporton se tre personat e përfshirë në vrasjen e "menaxherit të Vip-ve" janë arrestuar në Tiranë duke udhëtuar me makinë pasditen e djeshme. Në polici ata nuk kanë pranuar akuzat dhe nuk kanë dhënë detaje. Te rinjtë e kanë ndjekur për disa ditë Jurgen Kurtin dhe janë kapur nga kamerat e sigurisë duke udhëtuar me mjetin "Benz" që u përdor edhe ditën e vrasjes. Dëshmitarë dhe dëshmitarëve okularë, kamerat, si edhe informacionet policore kanë çuar në gjurmët e të arrestuarve.

**PASTRIMI I PARAVE**

Zbulohen lëvizjet/ Si u larguan nga Shqipëria 2 vëllezërit indianë

Të tjera detaje janë zbardhur për dy vëllezërit indianë, të cilët rezultojnë të shpallur në kërkim ndërkombëtar për veprën penale të pastrimit të parave.

Gazetarja Dorjana Bezat raporton për "BalkanWeb" se dy vëllezërit Nitin dhe Chetankumar Sandesara rezultojnë të jenë larguar nga Shqipëria më 20 mars 2019 nga aeroporti i Rinasit me avion "Charter".



Gjithashtu pas kontrolleve të kryera është faktuar se Nitin Sandesara kishte hyrë në Shqipëri nga Rinasit me 3 mars, ndërsa Chetankumar kishte hyrë në Shqipëri nga Rinasit me një linjë që vinte nga Parisi më 1 nëntor 2018. Gjykata në Neë Delhi ka miratuar kërkesën për ekstradim të bërë nga prokuroria, për dy vëllezërit Nitin Sandesara dhe Chetankumar Sandesara. Ata akuzohen për pastrim parash në shifra që kapin vlerën e rreth 725 milionë dollarëve.

**Krerët e PD mohojnë dijeninë për shumën 675 mijë dollarë**

**Lobimi në SHBA, prokuroria verifikon transfertat për "Biniatta Trade"**

Pas thirrjes në Prokurorinë e Tiranës të vetë kreut të Partisë Demokratike Luzlim Basha dhe zyrtarëve të lartë të selisë blu, grupi i hetuesve është fokusuar në zbardhjen e transfertave të parave që kompania 'Biniatta Trade' me qendër në Skoci ka bërë në emër të kësaj partie në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

**DESHMIA E MUZIN**

Prokuroria po pret dëshminë e Nicolas Muzin, themeluesit të kompanisë lobuese 'Muzin Capitol Partners', pasi ajo pritet të sqarojë nëse Partia Demokratike ka qenë në dijeni të këtyre pagesave të bëra nga 'Biniatta Trade'. Ardha e dëshmisë së Muzin pritet të mbyllë edhe dosjen hetimore dhe dërgimin e çështjes në gjykatë.

Demokratike Luzlim Basha dhe kompanisë 'Muzin Capitol Partners', parashikohen 3 pagesa nga 25 mijë euro për lobim dhe kontakte me zyrtarë të lartë të administratës së Presidentit Trump.

Por kontrata nga ku ka nisur hetimi është ajo e lidhur me 'Muzin Capitol Partneres' dhe 'Biniatta Trade', një kompanie që sipas revistës amerikane

'Mother Jones' ka pronarë rusë, por vetë kompania e ka muharur këtë.

Në këtë kontratë të deklaruar në Departamentin e Thesarit dhe Drejtësisë në Shtetet e Bashkuara, Muzin thotë se është paguar 675 mijë dollarë nga 'Biniatta Trade' për llogari të Partisë Demokratike. Drejtuesit e Partisë Demokratike kanë muhar kontaktet me 'Bini-



atta Trade', për pasojë edhe që ta kenë paguar atë. Por për Prokurorinë ka dyshime të arsyeshme se Partia Demokratike nuk ka deklaruar 650 mijë Dollarë dhe sipas akteve të ardhura nga letërporsitë, e mbërritura nga SHBA-ja dhe Skocia rezultojnë në mënyrë të qartë që pagesat janë bërë dhe nuk janë deklaruar, çka për akuzën nënkupton se Partia Demokratike nuk ka

bërë asnjë deklaram për këto pagesa në kundërshtim me ligjin.

Pagesat janë bërë në pranverën e vitit 2017 disa muaj para zgjedhjeve parlamentare. Origjina e tyre dhe arsyet përse 'Biniatta Trade' deklaroi se i ka paguar këto para për llogari të Partisë Demokratike, në një kohë që demokratët e mohojnë, janë edhe çelësi i hetimit.

**NJOFTIMI SHITJE ME ANKAND**

Përbarimi Gjyqësor Privat "Jon 2014", me përbaruese Jonida Ujkashi do të zhvillojë Ankandin e dytë për pasurinë :  
1- Njeshi, me sipërfaqe 64.10 m<sup>2</sup>, e ndodhur në Lagja Barikade, Berat, në Zonën Kadastrale 8501, Numri i Pasurisë: 8/147-N1, Vol. 22, Faqe. 87, në pronësi të Dorjana Gjovreni, Endrit Gjovreni, Beshtir Gjovreni. Çmimi me të cilin fillon shitja e kësaj pasurie është në vlerën e 4.953.648 (kater milion e nentëqind e tre mijë e gjashtëqind e dyzet e tetë) LEKE.  
Ankandi i dytë për pasurinë e mesipërme zhvillohet me datë 19.04.2019, ora 16:00 në ambientet e Zyrës së përbaruese gjyqësore private Jonida Ujkashi me adresë: Rr. "Myslym Shyri", vila nr.8/1, kt.4, Tiranë, nr. kontakti 0699381883 .

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE GJYQËSORE "3H" SH.p.k**  
Rr. "Tish Dala", Kompleksi Kika 2, Kulla 5, Kt. 1, Tiranë  
Web: www.3h.al; Email: shqgj\_3h@shqo.com; tel:0692099711

Njofton shpalljen e ankandit nga dt.26.03.2019 deri ne dt. 04.04.2019 per: sendin e luajshem mjeti me targe DR 9619 D ne pronesi te Hynsi Gjergji

**Cmimi fillestar eshte 560 EURO**

Ankandi zhvillohet ne zyrën përbarimore ne daten 04.04.2019 dhe mbyllet me orarin zyrtar 16.00



## REAGIMI



Të paktën 7 protestues të Unazës së Re mësohet të jenë shoqëruar mbrëmë nga Policia e Tiranës. Menjëherë pas ngjarjes, banorë të Unazës së Re dhe eksponentë të PD-së janë mbledhur para Drejtorisë së Policisë Tiranë për të kundërshtuar shoqërimet.

I pranishëm në protestë në mbështetje të banorëve të Unazës dhe për të kundërshtuar shoqërimet ishte edhe ish-deputeti i PD-së, Klevis Balliu.

## Shoqërohen 7 banorë të Unazës, protestë te policia

"Po bëhen plot 145 ditë që jemi në protestë. Dje dëgjova se qeveria ka bërë ndryshime. Të gjitha këto janë lojëra. Ikën këto drejtorët e policisë. A iku krimi?"

Këtu është vetëm një problem, kupola dhe krimi është vetëm Edi Rama. Dëgjova dje Erion Veliaj që po prralliste dje që po bëhet teatri. Që këta banorë janë keqpërdorur. Ti nuk denjove asnjëherë të vije këtu, por i the shpellarë. I vetmi shpellar je ti. Ai vjen këtu për t'i shkatërruar shtëpitë atyre, se ai nuk ka besë. Nuk mund të jesh shqiptar dhe të kanabizosh vendin.

Sot është kapur sistemi i drejtësisë. Fatkeqësisht në burg te Unaza sot është Danieli. Sot Edi Rama ti je më mirë, ndërsa qytetarët janë më keq. Se t'i rrite taksat që t'i blesh më lirë kur të ketë zgjedhje", tha Klevis Balliu.

Kërkon gjykim të shkurtuar: Nuk luftova për këtë sistem drejtësie. Ende ministër kampion

# Tahiri merret i pandehur për grup kriminal

"Më e rëndësishmja po vjen. Procesi kaloi kufijtë e një maskarade"

Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri ka folur pas vendimit të gjykatës për nisjen e gjykimin ndaj tij që e vendos zyrtarisht si të pandehur. Në një prononcim për mediat pas seancës 8 orëshe, Tahiri tha se të gjithë kishin shumë gjëra për të thënë por se më e rëndësishmja vjen.

"Zgjatë se kam përshlytjen të gjithë kishin gjëra për të thënë lidhur me atë që parashtruan prokurorët. Më shumë se afati 8 orë i zgjatjes së seancës sot, më vjen keq vetëm për ju që u detyruat të prisnit. Ajo që vjen para është më e rëndësishme se ajo që shkoi. Tani shkojmë në gjykim dhe ky është një shans për mua për të treguar atë që kam thënë gjithmonë. Nuk dua të merrem me llojin e seancës, me llojin e akuzës. Jam rezervuar të komentoj dhe nuk dua ta bëj dhe tani në respekt të një sistemi që kam kontribuar dhe unë deri diku", tha ish-ministri.

**Pse kërkua gjykim të shkurtuar?**

Unë kërkova që gjykimin të mos jetë një histori zvarritje e pafund. Prokuroria pretendon atë që pretendon, unë kam shumë më shumë për të pretenduar se sa prokuroria. Kështu që nuk ka nevojë për zgjatje pafundësisht dhe në këtë rast do ju lutesha juve që të bëni kujdes kur ta citoni dhe të saktësoni që unë vazhdoj dhe do vazhdoj deri në fund të argumentoj atë që kam thënë që nga fillimi që nuk kam pikën e lidhjes me këtë çështje. Atë që verifikoi prokuroria e Italisë, atë që verifikoi gjykata italiane. Prokurorët mendojnë që pikërisht vendimi i Italisë është që në qoftë se atje më gjeti që nuk kam lidhje fare, këtu prokurorët argumentojnë ndryshe. Kjo është çështje e tyre, do ta shohim



### DOSJET ME KARROCE

Kam pak zor të flas për veten në rastin kur gjendem në këto pozita. Do ndjek me përpikmëri çdo fazë të gjykimin. Nuk jam zënë me askënd. Di t'ju them që kur kjo ndodh me mua, merreni me mend ç'ndodh me njerëzit që s'kanë mundësi të flasin para jush. Nuk jam as ndonjë hero i heshtur, as s'më pëlqen kjo pozita e njeriut me poza heroike por di të them se realisht më vjen keq për njerëzit që vuajnë nga ky sistem drejtësie dhe nuk kanë mundësi të flasin - tha Tahiri.

në gjykim. Drejtësia prandaj është e bukur, pavarësisht se në shumicën dërrmuese të rasteve nuk bën drejtësi, por në ato pak raste kur bën drejtësi ia vlen.

**Si ishte të qëndrojnë 8 orë në gjykata, hera e parë dhe dosja juaj ka shkuar me karrocë në gjykatë, çfarë kishte ajo karrocë?**

Kam pak zor të flas për veten në rastin kur gjendem në këto pozita. Do ndjek me përpikmëri çdo fazë të gjykimin. Nuk jam zënë me askënd. Di t'ju them që kur kjo ndodh me mua, merreni me mend ç'ndodh me njerëzit që s'kanë mundësi të flasin para jush. Nuk jam as ndonjë hero i heshtur, as s'më

pëlqen kjo pozita e njeriut me poza heroike por di të them se realisht më vjen keq për njerëzit që vuajnë nga ky sistem drejtësie dhe nuk kanë mundësi të flasin.

**Keni pasur ndonjë kontakt me të bashkëpunuesit?**

Asnjë kontakt. **Ku bazohet prokuroria për të ngritur akuzën, pra cilat ishin provat konkrete që citoi organi i akuzës?**

Çfarë keni dëgjuar. Unë i kërkova prokurorisë të më bëjë një akuzë të qartë dhe të saktë, siç parashikon ligji. Prokuroria ka detyrimin që të më tregonte në seancë cilin veprim kam bërë unë që kam shkelur

Ka kohë për të të gjitha. Unë di t'ju them që ky proces i ka kapërcyer kufijtë e një maskarade të çdo lloj niveli. Po gjithësi unë nuk mërzitem fare me këtë, jam mësuar edhe shumë më keq se sa kaq, kështu që nuk më shqetëson asgjë nga këto dhe them që do ia dal, pa diskutim fare.

ligjin. Është shumë e thjeshtë. Prokuroria nuk u përgjigj. Pas disa herësh që u interesova dhe unë dhe gjykata, prokuroria nuk u përgjigj.

**Ju keni folur për trinitë e shenjtë seancën e kaluar, i qëndron kësaj?**

Nga sot e tutje që mbaron hetimi keni folur vetëm ju praktikisht, unë nuk

### AKUZAT NDAJ ISH-MINISTRIT

Prokuroria për Krimet të Rënda i mbylli hetimet në ngarkim të Tahirit më 28 shkurt dhe çoi dosjen në Gjykatë me akuzën për "Trafikim të lëndëve narkotike" në kuadër të grupit të strukturuar kriminal "Habilaj" dhe "Korrupsionit pasiv të funksionarëve të lartë shtetërorë".

them vetëm një gjë që e dyshoj shumë fort që ky është sistemi i drejtësisë për të cilin luftova. Gjithësi kjo mbetet për t'u parë.

**Çfarë shpresonit nga gjykata sot?**

Kjo është e gjitha një absurditet, kështu që çfarë të pretendoj. Kur unë i drejtohem prokurorisë dhe gjykatës dhe iu them, ore, më tregoni ku e kam shkelur ligjin dhe askush nuk më tregon dot një gjë, çfarë të them unë pastaj?!

**A është gjykata e varur apo e pavarur në rastin tuaj?**

Nuk di ta them këtë. Drejtësia prandaj është e bukur se kur ndodh që ndonjëherë bën drejtësi ia vlen në kurriz të shumë rasteve kur nuk bën drejtësi.

**A bëri drejtësi gjykatësja e seancës paraprake?**

Nuk dua të komentoj se kam konflikt interesi në këtë rast, unë isha personi në gjykim bashkë me të tjerë kështu që nuk dua të komentoj vendimet që më përkasin mua. Në një rast tjetër sigurisht do kisha shumë për të komentuar, siç kam bërë në të gjitha rastet për prokurorë dhe për gjyqtarë që kam menduar kanë shkelur ligjin siç e shoh që ndodh akoma në kurriz të njerëzve dhe pak njerëz flasin.

**Prokurorët a janë të pavarur në çështjen tuaj?**

Nuk ka rëndësi fare se nga varen dhe nga kush varen.

**A keni pengje për mënyrën se si keni drejtuar kur keni qenë ministër i Brendshëm?**

Tahiri: "Ky nuk mund të jetë momenti ku unë të rrefej jetën time".

-Sepse nga një ministër kampion jeni një i pandehur zyrtar.

Tahiri: "Unë jam prapë ministër kampion. Atë që kam bërë për Policinë e Shtetit nuk kthehem kurrë mbrapa".

Kush do të punësohet në pozicionin mami, fizioterapi, teknik imazherie e laborator

# Zbardhen emrat e 660 punonjësve të shëndetësisë, që do të punojnë në shtet

## Listat e plota të fituesve për të gjitha qarqet

Të gjithë ata që kanë konkurrar për një vend pune si punonjës të shkencave mjekësore teknike në portalin "Infermierë për Shqipërinë", mund të verifikojnë nëse kanë arritur të shpallen fitues. "Gazeta Shqiptare" zbardh sot listat me emrat e 660 aplikantëve të kualifikuar për të gjitha qarqet që do të kenë mundësinë të punësohen në shtet pas konkursit. Përkatesisht janë 220 fitues në pozicionin mami, 200 në fizioterapi, 148 në pozicionin teknik laborator dhe 88 në profi-



lin teknik imazherie. "Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 493, datë 13.11.2017 'Për administrimin e procedurave të punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë' të ndryshuar, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale publikon

listat përfundimtare të aplikantëve të kualifikuar, që morën pjesë në konkursin për profesionistë të shkencave mjekësore teknike", - thekson Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Gjithashtu, bëhet me dije se në listë janë përfshirë edhe aplikantët që janë kualifikuar nga konkurset e mëparshme dhe që nuk janë punësuar akoma.

EMRAT ME 660 PUNONJËSIT E SHËNDETËSISË QË DO TË PUNOJNË NË SHËNDETËSISË

Nr.	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Anxhela	Avduli	Elbasan	Fizioterapist	64.6
2	Albano	Mullahu	Elbasan	Fizioterapist	63.3
3	Jola	Xharo	Elbasan	Fizioterapist	62.3
4	Denis	Xhoxhaj	Elbasan	Fizioterapist	59.1
5	Perparim	Copani	Elbasan	Fizioterapist	56
6	Xhuljan	Kola	Elbasan	Fizioterapist	55.5
7	Marsela	Karaj	Elbasan	Fizioterapist	55.3
8	Donalda	Meço Kaçeli	Elbasan	Fizioterapist	55
9	Klead	Gjyla	Elbasan	Fizioterapist	54.5
10	Ajkuna	Telhaj	Elbasan	Fizioterapist	54.4
11	Elton	Haskasa	Elbasan	Fizioterapist	54
12	Endri	Prifti	Elbasan	Fizioterapist	53.6
13	Erida	Blogu	Elbasan	Fizioterapist	52.6
14	Irilda	Braho	Elbasan	Fizioterapist	52.3
15	Serxho	Puli	Elbasan	Fizioterapist	50.7
16	Lirjan	Zefi	Elbasan	Fizioterapist	49.9
17	Loredana	Dunga	Elbasan	Fizioterapist	49.3
18	Adelajda	Kutrolli	Elbasan	Fizioterapist	48.7
19	Isida	Cici	Elbasan	Fizioterapist	47.9
20	Eralda	Hatia	Elbasan	Fizioterapist	46.6
21	Andi	Met-hasani	Elbasan	Fizioterapist	45.2
22	Ani	Vercani	Elbasan	Fizioterapist	45.1
23	Elis	Kushova	Elbasan	Fizioterapist	45
24	Lubiana	Baku	Elbasan	Fizioterapist	44.4
25	Klint	Shkemi	Elbasan	Fizioterapist	44
26	Anis	Carku	Elbasan	Fizioterapist	42.4
27	Eleni	Koco	Elbasan	Fizioterapist	42
28	Fjoraba	Tanushi	Elbasan	Fizioterapist	42
29	Rudolf	Karriqi	Elbasan	Fizioterapist	40
Nr.	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Klead	Gjyla	Dibër	Fizioterapist	52.5
2	Isida	Cici	Dibër	Fizioterapist	47.9
3	Elis	Kushova	Dibër	Fizioterapist	47.5
4	Xhuljan	Kola	Dibër	Fizioterapist	47.5
5	Bertold	Keci	Dibër	Fizioterapist	41.7
6	Alfred	Koka	Dibër	Fizioterapist	41.4

Nr.	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Florenca	Spahiu	Durrës	Fizioterapi	70.4
2	Amarilda	Xhaferi	Durrës	Fizioterapi	68.3
3	Indrit	Smakaj	Durrës	Fizioterapi	63.9
4	Xhuljana	Cezmali	Durrës	Fizioterapi	62.7
5	Suela	Bodlli	Durrës	Fizioterapi	60.3
6	Denis	Xhoxhaj	Durrës	Fizioterapi	56.9
7	Irma	Dedej	Durrës	Fizioterapi	56.8
8	Klead	Gjyla	Durrës	Fizioterapi	54.5
9	Donalda	Meço Kaçeli	Durrës	Fizioterapi	53
10	Irilda	Braho	Durrës	Fizioterapi	52.3
11	Elis	Kushova	Durrës	Fizioterapi	50.5
12	Lirjan	Zefi	Durrës	Fizioterapi	49.9
13	Endri	Prifti	Durrës	Fizioterapi	48.6
14	Ajkuna	Telhaj	Durrës	Fizioterapi	48.4
15	Erand	Derjaj	Durrës	Fizioterapi	47.9
16	Isida	Cici	Durrës	Fizioterapi	47.9
17	Adelajda	Kutrolli	Durrës	Fizioterapi	47.7
18	Xhuljan	Kola	Durrës	Fizioterapi	47.5
19	Silva	Skapi	Durrës	Fizioterapi	46
20	Silvana	Mehmeti	Durrës	Fizioterapi	45.7
21	Andi	Met-Hasani	Durrës	Fizioterapi	45.2
22	Serxho	Puli	Durrës	Fizioterapi	44.7
23	Bledi	Jovani	Durrës	Fizioterapi	43.9
24	Fllanxa	Shurbi	Durrës	Fizioterapi	43.6
25	Silvi	Meta	Durrës	Fizioterapi	43.6
26	Kelsi	Ngjela	Durrës	Fizioterapi	43.4
27	Eleni	Koco	Durrës	Fizioterapi	42
28	Bertold	Keci	Durrës	Fizioterapi	41.7
29	Keana	Sulejmani	Durrës	Fizioterapi	41.3
30	Enis	Peku	Durrës	Fizioterapi	41
Nr.	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Xhuljan	Kola	Qarku Gjirokastër	Fizioterapist	55.5
2	Valbona	Nela	Qarku Gjirokastër	Fizioterapist	54.8
3	Klead	Gjyla	Qarku Gjirokastër	Fizioterapist	54.5
4	Ajkuna	Telhaj	Qarku Gjirokastër	Fizioterapist	54.4
5	Elis	Kushova	Qarku Gjirokastër	Fizioterapist	50.5
6	Isida	Cici	Qarku Gjirokastër	Fizioterapist	47.9
7	Erмира	Gjoni	Qarku Gjirokastër	Fizioterapist	41.7

Nr.	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Jorida	Shkullaku	Korçë	Fizioterapist	74
2	Xhuliana	Cezmelli	Korçë	Fizioterapist	64.7
3	Marinela	Gjysma	Korçë	Fizioterapist	60.8
4	Rudina	Kodra	Korçë	Fizioterapist	60.4
5	Xhuljan	Kola	Korçë	Fizioterapist	55.5
6	Eni	Cangtari	Korçë	Fizioterapist	55.1
7	Klead	Gjyla	Korçë	Fizioterapist	54.5
8	Ajkuna	Telhaj	Korçë	Fizioterapist	54.4
9	Elis	Kushova	Korçë	Fizioterapist	50.5
10	Adelajda	Kutrolli	Korçë	Fizioterapist	48.2
11	Isida	Cici	Korçë	Fizioterapist	47.9
12	Klaudija	Xhelali	Korçë	Fizioterapist	46.2
Nr.	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Klead	Gjyla	Kukës	Fizioterapi	52.5
2	Lirjan	Zefi	Kukës	Fizioterapi	49.9
3	Xhuljan	Kola	Kukës	Fizioterapi	47.5
4	Elis	Shushova	Kukës	Fizioterapi	44
5	Alfred	Koka	Kukës	Fizioterapi	41.4
Nr.	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Elizabeta	Dodaj	Lezhë	Fizioterapi	64.6
2	Erjona	Mata	Lezhë	Fizioterapi	54.9
3	Romina	Heta	Lezhë	Fizioterapi	53.4
4	Klead	Gjyla	Lezhë	Fizioterapi	52.5
5	Aurela	Marku	Lezhë	Fizioterapi	52.2
6	Lirjan	Zefi	Lezhë	Fizioterapi	49.9
7	Isida	Cici	Lezhë	Fizioterapi	47.9
8	Majlinda	Marku	Lezhë	Fizioterapi	47.9
9	Aristea	Gjergji	Lezhë	Fizioterapi	47.8
10	Xhuljan	Kola	Lezhë	Fizioterapi	47.5
11	Silvana	Shtjefni	Lezhë	Fizioterapi	45.1
12	Bertold	Keci	Lezhë	Fizioterapi	41.7
Nr.	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Indrit	Smakaj	Shkodër	Fizioterapi	63.9
2	Izmir	Haxhija	Shkodër	Fizioterapi	58.3
3	Edra	Kurtaj	Shkodër	Fizioterapi	55.6
4	Olta	Leka	Shkodër	Fizioterapi	54.8
5	Miranda	Guri	Shkodër	Fizioterapi	53.1
6	Klead	Gjyla	Shkodër	Fizioterapi	52.5
7	Fatjon	Broci	Shkodër	Fizioterapi	50.9
8	Lirjan	Zefi	Shkodër	Fizioterapi	49.9
9	Isida	Cici	Shkodër	Fizioterapi	47.9
10	Erestina	Qehaja	Shkodër	Fizioterapi	47.8
11	Adelajda	Kutrolli	Shkodër	Fizioterapi	47.7
12	Xhuljan	Kola	Shkodër	Fizioterapi	47.5
13	Jonila	Pirani	Shkodër	Fizioterapi	44.3
14	Odensa	Mustafa	Shkodër	Fizioterapi	40.7

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Jorida	Shkulaku	Tiranë	Fizioterapi	74
2	Florenca	Spahiu	Tiranë	Fizioterapi	70.4
3	Enxhi	Bello	Tiranë	Fizioterapi	67
4	Elisabeta	Dodaj	Tiranë	Fizioterapi	64.6
5	Jola	Xharo	Tiranë	Fizioterapi	64.3
6	Indrit	Smakaj	Tiranë	Fizioterapi	63.9
7	Anxhela	Ahmataj	Tiranë	Fizioterapi	63.8
8	Anxhela	Avduli	Tiranë	Fizioterapi	63.6
9	Rudina	Kodra	Tiranë	Fizioterapi	63.4
10	Xhuljana	Cezmalli	Tiranë	Fizioterapi	62.7
11	Dajana	Veliqaj	Tiranë	Fizioterapi	61.3
12	Suela	Bodlli	Tiranë	Fizioterapi	60.3
13	Leonarda	Dunga	Tiranë	Fizioterapi	59.4
14	Romina	Shehaj	Tiranë	Fizioterapi	58.2
15	Tedi	Strakosha	Tiranë	Fizioterapi	58
16	Denis	Xhoxhaj	Tiranë	Fizioterapi	56.9
17	Behije	Marra	Tiranë	Fizioterapi	56.7
18	Ensi	Xhurxhi	Tiranë	Fizioterapi	55.8
19	Romina	Branica	Tiranë	Fizioterapi	55.3
20	Erjona	Mata	Tiranë	Fizioterapi	54.9
21	Esmeralda	Dama	Tiranë	Fizioterapi	54.8
22	Valbona	Nelaj	Tiranë	Fizioterapi	54.8
23	Xhulja	Lula	Tiranë	Fizioterapi	54.6
24	Florida	Beqiraj	Tiranë	Fizioterapi	54
25	Elton	Almadhi	Tiranë	Fizioterapi	53.7
26	Lirjan	Zefi	Tiranë	Fizioterapi	53.7
27	Anxhela	Sulo	Tiranë	Fizioterapi	53.6
28	Romina	Heta	Tiranë	Fizioterapi	53.4
29	Donalda	Meço Kaçeli	Tiranë	Fizioterapi	53
30	Brent	Shtishi	Tiranë	Fizioterapi	52.6
31	Alban	Merdani	Tiranë	Fizioterapi	52.5
32	Klead	Gjyla	Tiranë	Fizioterapi	52.5
33	Irida	Braho	Tiranë	Fizioterapi	52.3
34	Klaus	Shaqiri	Tiranë	Fizioterapi	52
35	Erida	Blogu	Tiranë	Fizioterapi	51.6
36	Elio	Caushi	Tiranë	Fizioterapi	51
37	Mario	Balalla	Tiranë	Fizioterapi	50.9
38	Ilda	Lumi	Tiranë	Fizioterapi	50
39	Daniela	Nelaj	Tiranë	Fizioterapi	49.9
40	Lirjan	Zefi	Tiranë	Fizioterapi	49.9
41	Marda	Luzi	Tiranë	Fizioterapi	49.7
42	Eduart	Abedini	Tiranë	Fizioterapi	49.2
43	Endri	Priifti	Tiranë	Fizioterapi	48.6
44	Ajkuna	Telhaj	Tiranë	Fizioterapi	48.4
45	Borald	Myftaraj	Tiranë	Fizioterapi	48
46	Isida	Cici	Tiranë	Fizioterapi	47.9
47	Majlinda	Marku	Tiranë	Fizioterapi	47.9
48	Adelajda	Kutrolli	Tiranë	Fizioterapi	47.7
49	Doklejd	Lama	Tiranë	Fizioterapi	47.5
50	Elis	Kushova	Tiranë	Fizioterapi	47.5
51	Xhuljan	Kola	Tiranë	Fizioterapi	47.5
52	Armando	Ilnici	Tiranë	Fizioterapi	46.7
53	Evelina	Hoxhaj	Tiranë	Fizioterapi	46.6
54	Irdi	Mullita	Tiranë	Fizioterapi	46.2
55	Ramiz	Reci	Tiranë	Fizioterapi	46.1
56	Elona	Rama	Tiranë	Fizioterapi	45.6
57	Ana	Hajdari	Tiranë	Fizioterapi	45.5
58	Andi	Met-hasani	Tiranë	Fizioterapi	45.2
59	Anxhela	Bruçi	Tiranë	Fizioterapi	45
60	Serxho	Puli	Tiranë	Fizioterapi	44.7
61	Fllanxa	Shurbi	Tiranë	Fizioterapi	43.6
62	Silvi	Meta	Tiranë	Fizioterapi	43.6
63	Leonard	Meco	Tiranë	Fizioterapi	43.5
64	Kelsi	Ngjela	Tiranë	Fizioterapi	43.4
65	Erald	Pepaj	Tiranë	Fizioterapi	42.5
66	Stela	Mullxhi	Tiranë	Fizioterapi	42.3
67	Mariglen	Sula	Tiranë	Fizioterapi	42.1
68	Eleni	Koco	Tiranë	Fizioterapi	42
69	Bertold	Keci	Tiranë	Fizioterapi	41.7
70	Mira	Kapaj	Tiranë	Fizioterapi	40.6
Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Alfrida	Isaku	Diber	Mami	52.1
2	Esmeralda	Skonja(Lushi)	Diber	Mami	48.5
3	Elda	Doku	Diber	Mami	45.8
4	Migena	Kadiu	Diber	Mami	45.5
5	Jonida	Reçi	Diber	Mami	45.1

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Mirvenisa	Rama	Berat	Mami	62.2
2	Egesa	Dodoveci	Berat	Mami	61.7
3	Anxhela	Bendaj	Berat	Mami	61.3
4	Andiola	Kumaraku	Berat	Mami	61.2
5	Eneralda	Shpataraku	Berat	Mami	59.4
6	Gersjana	Penxho	Berat	Mami	58.7
7	Anxhela	Hysko	Berat	Mami	57.5
8	Arjola	Koci	Berat	Mami	55.7
9	Rozeta	Domi	Berat	Mami	55.1
10	Klejvi	Seitaj	Berat	Mami	55
11	Eda	Llapri	Berat	Mami	52.8
12	Viola	Stavri	Berat	Mami	52.1
13	Anxhela	Isufaj	Berat	Mami	52
14	Anxhela	Penxho	Berat	Mami	49.8
15	Anxhela	Cobo	Berat	Mami	48.6
16	Denisa	Hëna	Berat	Mami	48.5
17	Xhuli	Tafa	Berat	Mami	47.7
18	Eva	Troka	Berat	Mami	46.9
19	Belina	Dyshniku	Berat	Mami	46.4
20	Brunilda	Lala	Berat	Mami	41.5
21	Fjona	Pasholli	Berat	Mami	41.5
22	Klevisa	Cala	Berat	Mami	40.7
23	Blenarda	Likaj	Berat	Mami	40.4
24	Safigje	Zelo	Berat	Mami	40
Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Juli	Boja	Durrës	Mami	65.5
2	Vitorie	Biloshmi	Durrës	Mami	63.1
3	Merita	Karaj	Durrës	Mami	60
4	Aurora	Vrapj	Durrës	Mami	56.3
5	Xheni	Hasani	Durrës	Mami	55.8
6	Silvana	Kercani	Durrës	Mami	55.1
7	Arjola	Blushi	Durrës	Mami	53.1
8	Xhesika	Resuli	Durrës	Mami	52.2
9	Esmeralda	Dervishi	Durrës	Mami	52
10	Aviola	Papa	Durrës	Mami	51.7
11	Sajrije	Qoshja	Durrës	Mami	51
12	Olta	Keçi	Durrës	Mami	49.7
13	Zhuljana	Hoxhallari	Durrës	Mami	49.4
14	Esma	Rahi	Durrës	Mami	49.1
15	Pashke	Paluka	Durrës	Mami	48.7
16	Albina	Doka	Durrës	Mami	48.4
17	Merita	Sina	Durrës	Mami	48.4
18	Bejtjana	Hasneziraj	Durrës	Mami	47.6
19	Jona	Drabo	Durrës	Mami	47.1
20	Ari	Sylari	Durrës	Mami	46.8
21	Klodjana	Kurti	Durrës	Mami	46.7
22	Fazile	Zagradi	Durrës	Mami	46.2
23	Anila	Prenja	Durrës	Mami	44.6
24	Sonila	Krrashi	Durrës	Mami	43.1
25	Jonida	Cani	Durrës	Mami	42.9
26	Jurgena	Lila	Durrës	Mami	42
27	Luljeta	Troplini	Durrës	Mami	42
28	Olta	Keci	Durrës	Mami	41.7
29	Greta	Priifti	Durrës	Mami	41.6
30	Merita	Allaraj	Durrës	Mami	41.5
Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Eneralda	Shpataraku	Qarku Vlorë	Mami	59.4
2	Dhurata	Hoxhaj	Qarku Vlorë	Mami	57.3
3	Florina	Pecaj	Qarku Vlorë	Mami	56.7
4	Xhesjana	Gela	Qarku Vlorë	Mami	54.7
5	Arjola	Luto	Qarku Vlorë	Mami	48.4
6	Xhevaire	Meminaj	Qarku Vlorë	Mami	44.8
7	Aleksander	Bocova	Qarku Vlorë	Mami	53.4
8	Dajana	Pajollari	Qarku Vlorë	Mami	51.9
9	Albjona	Bilani	Qarku Vlorë	Mami	47.1
10	Eneida	Katij	Qarku Vlorë	Mami	46.4
11	Venida	Lama	Qarku Vlorë	Mami	45.8
12	Morena	Bërdufi	Qarku Vlorë	Mami	41.3
Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Velma	Hysaj	Gjrokastër	Teknik Laboratori	63.1
2	Lindita	Toska	Gjrokastër	Teknik Laboratori	53.6
3	Orjanda	Todhe	Gjrokastër	Teknik Laboratori	51.2
4	Jona	Ruli	Gjrokastër	Teknik Laboratori	47.4
5	Rexhina	Haxhiu	Gjrokastër	Teknik Laboratori	46.8
6	Mirela	Shguni	Gjrokastër	Teknik Laboratori	45.3
Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Marsela	Kanaci	Berat	Teknik Laboratori	60
1	Elda	Kapllani	Berat	Teknik Laboratori	58.5
3	Rexhina	Haxhiu	Berat	Teknik Laboratori	54
4	Sidorela	Maja	Berat	Teknik Laboratori	51.5

Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Rezoalda	Shega	Shkodër	Mami	61.9
2	Arjeta	Bajraktari	Shkodër	Mami	61
3	Flutur	Kurtaj	Shkodër	Mami	58.9
4	Arba	Rrjollj	Shkodër	Mami	58.7
5	Manjola	Gegaj	Shkodër	Mami	57.6
6	Arsida	Smakaj	Shkodër	Mami	57.1
7	Sonila	Cuku	Shkodër	Mami	56.1
8	Fidarije	Dani	Shkodër	Mami	55.8
9	Leonida	Franja	Shkodër	Mami	54.3
10	Terezina	Cardaku	Shkodër	Mami	54.3
11	Leta	Marku	Shkodër	Mami	54
12	Diana	Bungu	Shkodër	Mami	52.5
13	Ergys	Plori	Shkodër	Mami	52
14	Saide	Meti	Shkodër	Mami	52
15	Fatime	Logja	Shkodër	Mami	51.9
16	Arjola	Metaj (Jukaj)	Shkodër	Mami	51.6
17	Klea	Selimaj	Shkodër	Mami	51.2
18	Kristine	Livadhi	Shkodër	Mami	50.9
19	Ageldi	Dizdari	Shkodër	Mami	50.7
20	Aurela	Dodaj	Shkodër	Mami	48.3
21	Xhulia	Dodaj	Shkodër	Mami	48.2
22	Amanda	Zekaj	Shkodër	Mami	48.1
23	Stela	Pano	Shkodër	Mami	47.7
24	Etleva	Vejuka	Shkodër	Mami	46.9
25	Sidorela	Kodra	Shkodër	Mami	46.8
26	Iden	Puci	Shkodër	Mami	46.4
27	Edona	Kraja	Shkodër	Mami	45.4
28	Esmeralda	Trumci	Shkodër	Mami	45.3
29	Briselda	Neziri	Shkodër	Mami	45.1
30	Arjola	Alikaj	Shkodër	Mami	44.9
31	Iris	Halluni	Shkodër	Mami	44.4
32	Medina	Kerjota	Shkodër	Mami	43.9
33	Evelina	Shpati	Shkodër	Mami	42.8
34	Dorina	Gjoni	Shkodër	Mami	42.3
35	Kristiana	Qepuri	Shkodër	Mami	42.3
36	Valbona	Gjergjaj	Shkodër	Mami	42.1
37	Elkida	Cekaj	Shkodër	Mami	42
38	Manjola	Ndoj	Shkodër	Mami	41.4
39	Marsela	Tanushi	Shkodër	Mami	41.4
40	Marjana	Sokoli	Shkodër	Mami	41.2
Nr	Emër	Mbiemër	Qarku	Profesioni	Totali
1	Andia	Hoxha	Tiranë	Mami	63.7
2	Vitorie	Biloshmi	Tiranë	Infermiere -Mami	63.1
3	Xhulia	Muka	Tiranë	Mami	61.8
4	Andiola	Kumaraku	Tiranë	Mami	61.2
5	Drilona	Kortoci	Tiranë	Mami	61
6	Rukije	Bulku	Tiranë	Mami	60.5
7	Elona	Priifti	Tiranë	Mami	60
8	Hasije	Groshta	Tiranë	Mami	60
9	Eni	Rrusheku	Tiranë	Mami	59.7
10	Dave	Gjoka	Tiranë	Mami	59.4
11	Adelajda	Varrosi	Tiranë	Mami	58.8
12	Aida	Shehi	Tiranë	Mami	58.8
13	Gersjana	Penxho	Tiranë	Mami	58.7
14	Erjona	Morina	Tiranë	Mami	58
15	Rigerta	Hoxha	Tiranë	Mami	58
16	Anxhela	Hysko	Tiranë	Mami	57.5
17	Nazjola	Beka	Tiranë	Mami	57.2
18	Emanuela	Bashalli	Tiranë	Infermiere Mami	56.8
19	Valona	Kasamaj	Tiranë	Mami	56.5
20	Valbona	Stani	Tiranë	Infermiere Mami	56.1
21	Jola	Cela	Tiranë	Mami	55.8
22	Albina	Ismahili	Tiranë	Mami	55.6
23	Ina	Koljegjaja	Tiranë	Mami	55.1
24	Megi	Mana	Tiranë	Mami	54.7
25	Arjola	Toci	Tiranë	Mami	54.5
26	Blerina	Balla	Tiranë	Infermiere - Mami	54.5
27	Arjentina	Qefa	Tiranë	Infermiere Mami	54
28	Johana	Heqimi	Tiranë	Mami	53.2
29	Suela	Giuzi	Tiranë	Mami	52.8
30	Shpresa	Belba	Tiranë	Mami	52.7
31	Alfrida	Isaku	Tiranë	Mami	52.1
32	Esmeralda	Dervishi	Tiranë	Mami	52
33	Jurgesa	Belba	Tiranë	Infermiere Mami	51.9
34	Katerina	Pera	Tiranë	Mami	51.4
35	Rezarta	Haka	Tiranë	Mami	51.2
36	Brunilda	Alla	Tiranë	Mami	51.1
37	Rosartja	Tafxhafa	Tiranë	Mami	51.1
38	Elisara	Berberi	Tiranë	Mami	51.1
39	Angjela	Hyka	Tiranë	Mami	51
40	Romilda	Torollari	Tiranë	Mami	51
41	Sosina	Datja	Tiranë	Mami	51
42	Mimoza	Poka	Tiranë	Mami	50.9

## Urdhri i MASR: Kriteret që duhen plotësuar

### Si do të bëhet përzgjedhja e 8 anëtarëve të bordit të administrimit në 3 universitete

Ministria e Arsimit, Sportit e Rinisë ka rishpallur procedurat e përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve për anëtarë të bordit të administrimit si përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë. 'Gazeta Shqiptare' zbardh sot urdhrin e MASR si dhe kriteret që kandidatët duhet të përmbushin për të qenë anëtarë të bordit të administrimit. Lista e kandidatëve të kualifikuar do të publikohet në faqen zyrtare të ministrisë përgjegjëse për arsimin, [www.arsimi.gov.al](http://www.arsimi.gov.al). "Në zba-



tim të vendimit nr. 782, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, "Për përcak-

NUMRI I ANËTARËVE PËR BORD	
1. Universiteti i Tiranës	2
2. Universiteti i Mjekësisë, Tiranë	3
3. Universiteti "Eqrem Çabej", Gjirokastrë	3

timin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për

Arsimin, në institucionet publike të arsimit të lartë", Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë shpall njoftimin për fillimin e procedurave

të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit për 3 institucionet publike të arsimit të lartë", thuhet në urdhrin e ministrisë. Bordi i Administrimit është organi më i lartë kolegial administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi i Administrimit në institucionet publike të arsimit të lartë përbëhet nga shtatë anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme. Anëtarët, përfaqësues të IAL-së, përzgjidhen nga Senati Akademik i IAL-së për një mandat pesëvjeçar, me të drejtë rrizgjedhjeje, prej listave të propozuara

nga institucioni i arsimit të lartë. Në listën e kandidatëve jepen të dhënat e individëve që vetëkandidojnë apo propozohen nga njësitë bazë të institucionit të arsimit të lartë apo institucioneve përkatëse. Anëtarët përfaqësues të Ministrisë përgjegjëse për Arsimin dhe njësisë së qeverisjes vendore janë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike dhe emërohen përkatësisht nga ministri përgjegjës për arsimin dhe kryetari i njësisë së qeverisjes vendore, sipas përcaktimeve të ligjit për arsimin e lartë.

## Ogerta Manastirliu: Do të forcojmë mekanizmat ndaj korrupsionit në spitale

# Dhuna ndaj bluzave të bardha, ministria premtonte ndryshime në Kodin Penal

"Kanosja dhe goditja do të dënohen me burg"

Pas rasteve të shpeshta të dhunës ndaj bluzave të bardha, do të merren masa konkrete për sigurinë dhe mbrojtjen e tyre në punë. Gjatë një tryeze diskutimi me mjekët, me prezencën e kryeministrit Edi Rama dhe përfaqësues të institucioneve, ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu ka prezantuar dy propozimet e ndryshimit të kodit penal, që synon ashpërsimin e masave në rast të kanosjes dhe goditjes për shkak të detyrës si dhe dekriminalizimin e gabimit mjekësor: "Dhuna është e patolerueshme, është primitivizëm dhe në çdo rast nuk mund të jetë zgjidhja. Ndaj kemi sot disa propozime për ndryshime në Kodin Penal, të cilat janë punuar nga një ekip i përbashkët i Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe profesionistëve të shëndetit. E para lidhet me ashpërsimin e masave në Kodin Penal. Duke vendosur kanosjen dhe goditjen për shkak të detyrës ndaj profesionistëve të shëndetit si veprë penale që do të dënohet me burg. E dyta lidhet me dekriminalizimin e gabimit mjekësor. Një kërkesë tashmë e kahershme e të gjithë profesionistëve të shëndetit, për të ndarë gabimin mjekësor nga neglizhenca, bazuar në praktikën më të mira Europiane" - është shprehur Manastirliu.

### REGJIMI I RI NË SPITALE

Ogerta Manastirliu në fjalën e saj ka theksuar rëndësinë që ka zbatimi i regjimit të ri të vendosur në spitale, si një mënyrë për të parandaluar sa më shumë dhunën ndaj mjekëve, por edhe disiplinimin e vizitave të familjarëve të pacientëve. "Marrëdhënia mjek-pacient nuk kurohet duke vendosur policë, por ajo mund të kurohet, mund të shëndoshet duke vendosur disiplinën dhe rregullin në spitale dhe duke zbatuar regjimin e ri që tashmë ne e kemi vendosur në spitalet tona dhe



për këtë, bashkëpunimi kërkohet pikë së pari nga ju" - deklaroi ministria. **DENONCIMI I KORRUPSIONIT**  
Krahas masave kundër dhunës dhe kanosjes ndaj

mjekëve, ministria Manastirliu u ndal në fjalën e saj edhe tek fuqizimi i mekanizmave që qytetarët mund të përdorin për të denoncuar rastet e korrupsionit dhe shpërdorimit të

detyrës. "Mes bluzave të bardha ka dhe nga ata që se meritojnë të jenë pjesë e shërbimeve tona në shëndetësi. Ata që e nullojnë bluzën e bardhë fatmirësisht janë raste të rralla,

**DENONCIMET**  
"Ne do të vijojmë të forcojmë të gjitha mekanizmat e denoncimit, të krijojmë të gjitha kanalet e komunikimit me qytetarët, me pacientët, për të denoncuar çdo rast korrupsioni, çdo rast abuzimi, çdo rast neglizhence", - tha Manastirliu.

**REGJIMI I RI**  
"Marrëdhënia mjek-pacient nuk kurohet duke vendosur policë, por ajo mund të kurohet, mund të shëndoshet duke vendosur disiplinën dhe rregullin në spitale dhe duke zbatuar regjimin e ri që tashmë ne e kemi vendosur në spitalet tona dhe për këtë, bashkëpunimi kërkohet pikë së pari nga ju", - deklaroi ministria.

shumë sporadike, por ekzistojnë dhe janë ato raste që kanë sjellë këtë perceptim për mjekët, për korrupsionin, për rryshfëtim. Ne do të vijojmë të forcojmë të gjitha mekanizmat e denon-

cimit, të krijojmë të gjitha kanalet e komunikimit me qytetarët, me pacientët, për të denoncuar çdo rast korrupsioni, çdo rast abuzimi, çdo rast neglizhence", -tha Manastirliu.

Tashmë aplikacioni "Tirana ime" vjen me një tjetër risi, atë të monitorimit të cilësisë së ajrit. Në funksion të kësaj, Bashkia e Tiranës ka instaluar matësa në zonën e Kasharit, të "21 Dhjetori", të "Rr.Elbasanit" dhe të sheshi "Skënderbej". Sensorët inteligjentë do të përcojnë të dhëna në kohë reale nëpërmjet rrjetit, drejtpërsëdrejti në aplikacionin "Tirana



## Monitorim i cilësisë së ajrit në kryeqytet, risi në aplikacionin "Tirana ime"

Ime". "Një nga gjërat që dua të vlerësoj jashtë mase është se kemi marrë teknologjinë më të fundit, që nuk ka tjetër në rajon. Sot planifikojmë lançimin e aplikacionit që mat ndotjen e ajrit në Tiranë në kohë reale, në mënyrë që çdo qytetar, ashtu siç ka

akses te kamerat e qytetit, raportimet, trafiku, të ketë akses edhe në këtë informacion. Vendimarrja për të gjithë në këtë moment është në të vërtetë e dimë të gjithë", -tha kryebashkiaku. Ky i fundit premtoi se deri në 2030, flota e autobusëve do të jetë elektrike.

"Përveç 2 milionë pemëve, kemi vendosur si target që 100% e taksive të jenë elektrike ose hibride brenda vitit 2025.100% e autobusëve do të jenë elektrike brenda vitit 2030, një operacion që e fillojmë tani dhe kemi 11 vite kohë ta realizojmë", - bëri me dije Veliaj.

# VIP

Suplement  
*Pages*

Enërkurë 27 Mars 2019

GAZETA SHQIPTARE

Redaktore: Pamela Aliaj


## "BULEVARDI POLITIK"

- Kostumi 300 mijë lekë", Erion Braçe prezanton rrobaqepësin e vet
- Hipur mbi rul, Xhelal Mziu bëhet gati për... zgjedhje?
- Meghan Markle shpenzoi gjatë shtatzënisë rreth 580 mijë euro
- Ish-ministri bëhet 42 vjeç, dhurata speciale për të

"Është këngëtare koti",  
Ronela Hajati reagon ndaj  
deklaratës së Çanit



Nga Adlina Ismajli te Ronela Hajati, të famshmit që nuk komunikojnë bashkë



"Hiq getat dhe këpucët!",  
Rudina Magjistari reagon pas  
komentit të ndjekëses



## Nga miq për kokë në armiq, **VIP-at** që 'urrejnë' njëri-tjetrin

*Zili, keqkuptim apo konkurrencë? Shkaqet e zënkarave të njerëzve të njohur mes tyre*

Nga Adlina Ismajli te Ronela Hajati, të famshmit që nuk komunikojnë bashkë

# Nga miq për kokë në armiq, VIP-at që 'urrejnë' njëri-tjetrin

Zili, keqkuptim apo konkurrencë? Shkaqet e zënkave të njerëzve të njohur mes tyre

Pamela Aliaj

**E**dhe pse ka kaluar shumë kohë dhe me siguri asnjë nuk e mban mend më arsyen e zënkës, besojeni apo jo, por këta njerëz të famshëm ende nuk flasin me njëri-tjetrin! Kush për zili, kush për keqkuptim e kush për inate e konkurrencë, shkaqet janë të ndryshme, por rezultati mbetet i njëjtë: ata nuk flasin me njëri-tjetrin. Nga shokë/shoqe për kokë, tanimë nuk flasin më me gojë. Të shohim disa prej tyre më posthë dhe arsyet e zënies së tyre. Me shumë mundësi mund t'ju duken absurde, por ky është realiteti për disa prej tyre.

## GENTA ISMAILI DHE DAFINA ZEQIRI

Dy këngëtares e dashura si në Shqipëri ashtu edhe në Kosovë nuk i gëzohen suksesit të njëra-tjetrës. Armiqësinë mes tyre e nxori zbuluar menaxheri personal i Gentës në momentin që pati një konflikt mes tyre. Ai u shpreh se "Gentën e tmerron suksesi i Dafina Zeqirit dhe e shan shumë atë". Dafina dhe Genta kanë qenë rivale të flakta gjatë viteve të fundit, me një ndarje 50 me 50 të fansave.

## ROZANA RADI DHE REZARTA SHKURTA

Kjo është një nga përplasjet më të komentuar të showbizit shqiptar, pasi degjeneroi në një dhunë të fuqishme fizike. Krisja mes Rozana Radit dhe Rezarta Shkurtës nisi në shown "Vip Shpija" në Kosovë. Në dukje ishte një zënkë banale dhe vetë ato të dyja u përpoqën ta kalojnë me sportivitet, duke uruar njëra-tjetrën për suksesin e radhës në festivalin "Kënga Magjike". Por pak kohë më vonë dy vajzat u zunë keq me njëra-tjetrën. Të dyja artistet pretenduan pafajësinë dhe pas një procesi të gjatë gjykata vendosi që ta shpallte Rezarta Shkurtën jo fajtorë ndaj akuzave të Radit, e cila, nga ana tjetër, ka thënë se do ta çojë çështjen në Gjykatën e Apelit. Nuk e dimë nëse gjyqi ka vazhduar ende, por një gjë është e sigurt: Këto të dyja nuk do të jenë më kur- rë mike si më parë.

## ADELINA ISMAJLI DHE LEONORA JAKUPI

Ky është një sherr shumë i her- shëm. Gjithçka nisi gati një dekadë më parë në backstage-t e një koncerti, ku bëheshin parapërgatitjet për regjistrimet e një spektakli për Vitin e Ri. Ende nuk dihen arsyet se përse ato janë zënë atë kohë, veç thashethemeve se rrahja e tyre më shumë ka qenë për çështje politike sesa për çështje xhelozie. Në një intervistë që i është Adeline Ismajlit, ajo ka thënë se është shpallur e pafajshme nga rrahja. E ndër- sa




pyetjes nëse janë pajtuar këngëtarja i është përgjigjur se nuk e sheh të arsyeshme. Pas deklaratave të Adelinsë, nuk ka munguar reagi- mi i këngëtares tjetër të njohur Leonora Jakupi, e cila ka kërkuar ballafaqim publik. "Asgjë nga ato që ka thënë nuk është e vërtetë. Nuk mund të dalë në një studio ashtu kot dhe të thotë gjëra të paqena. Pse doli të flasë për këtë çështje pas 10 vitesh?! E ftoj në një de- bat publik, sepse, në ndryshim nga ajo, unë i kam gjerat e faktura, "- ka thënë Leonora.

## NOIZY DHE STRESI

Këta dy reperat duket se nuk do t'i hapin kurrë rrugë njëri-tjetrit. Janë bërë armiq të betuar që në fillim të karrierave dhe konfliktet sa vijnë e thellohen. Madje pas një sulmi me thika ku u përshinë fan- sat e grupit OTR, Denis Dollapi përfundoi në gjendje kome. Kjo është një urrejtje që u ngjan lagjeve "geto" ku bëhet rep në Amerikë, por që shkaktojnë edhe viktime.

## ALTUNA SEJDIU DHE ADELINA TAHIRI

Dy këngëtares nga Shkupi nuk shkojnë fare mirë me njëra-tjetrën. Shpesh kanë qarkulluar zëra se këngëtares u bënë armike pasi të dyja janë përfolur për një flirt me Blerim Destanin edhe pse në fund të kësaj historie aktori nuk rezultoi në një marrëdhënie me asnjërën prej të dyjave. Në ko- hën që kanë qarkulluar këto thash- etheme, Adelina ka pohuar se në jetën e saj e ka takuar vetëm një



herë Blerim Destanin. Ndërkohë Adelina një armiqësi të heshtur të kësaj natyre e ka pasur me Genta Ismajlin për futbollistin Lorik Cana.

## BIG BASTA DHE SAMANTA

Ata patën një bashkëpunim mjaft të sukseshëm me titullin "Start" por që sot nuk flasin më me njëri-tjetrin. Samanta kohë më parë ka qenë pjesë e studios së "Big Bastës" dhe bashkëpunimi mes tyre duket se ishte në rrugë të mbarë derisa nisën problemet. Si- pas reperit, Samanta refuzoi t'i paguante lekët e këngës Big Bastës.

## DORINA MEMA DHE ENCA HAXHIAJ

Sherrri mes tyre ka nisur në 2016-ën pasi Dorina Mema fitoi 'DWT'S'. Kjo e fundit gjatë një in- terviste u shpreh se i vinte ta priste më gërhërë Encën për shkak të peshës. Nuk vonoi shumë dhe er- di edhe reagimi i këngëtares. "Më fal, nuk promovoj njerëz budallenj dhe të mërzitshëm falas. Kërko për famë diku tjetër; "- shkruante Enca në Saphcat.

## ROZA LATI DHE AURELA HOXHA

Ishte moderatorja Lati ajo që e nisi konfliktin ku komentoi pam- jen e jashtëme të modeles Hoxha. E ftuar në 'Da'Sara' ajo tha: "Aurela do ketë patur frikë të vije, sepse nuk është reale. Reale nga person- aliteti, se nga pamja e dimë që nuk është". Më pas Roza i përmendi Au- relës edhe faktin që e çoi i dashu- ri me pushime në Maldivë dhe Taj- landë. Por Hoxha nuk reagoi në asnjë rast, thjesht vendosi ta in- joronte.

## ÇILJETA XHILAGA DHE ZAJMENA VASJARI

Asnjëherë nuk është vërtetuar si konflikt. Por shpesh është për-

folur se vajzat u zunë në fillimet e tyre për një të dashur. Megjithatë sot këngëtares ruajnë një miqësi mjaft të mirë.

## ÇILJETA XHILAGA DHE FILLLORETA RAÇI (FIFI)

Dy këngëtares e njohura sh- qiptare, Çiljeta Xhilaga dhe Filloreta Raçi, dikur kanë qenë shoqe shumë të ngushta. Madje e ftuar në një emision televiziv, Çiljeta ka treguar se për shumë kohë ajo ka qenë mikpritëseja e Fifit në Tiranë esaj. Mirëpo ka qenë Fifi, ajo e cila në një intervistë i ka kërkuar falje publikisht Çiljetës. Ajo ka deklaruar se Çiljeta Xhilaga është mërzit- ur me të pasi ajo i ka dhënë pak pikë për këngën e saj "Hajmali" gjatë konkurrimit tek "Kënga Magjike".

## RONELA HAJATI DHE SAMANTA KARAVELLA

Nga dy shoqe që shfaqeshin kudo bashkë u larguan krejtësisht nga njëra-tjetra. E pyetur në një in- tervistë, Ronela tha si me ironi, që Samanta është vajzë shumë e mirë dhe s'ka asgjë me të. Kohë e fun- dit ato janë pajtuar pasi Ronela postoi një video në 'InstaStory' duke kënduar këngën e Samantës "Zemrën maje".

## LEDION LIÇO DHE NOIZY

Gjatë hapjes së spektaklit "Top Award", Ledion Liço përshëndeti të ftuarit dhe në një moment u ndal tek Noizy, i cili nuk kishte ardhur. "Noizy do të duhej të ishte këtu, por ai erdhi në prova me mak- inën e tij 'Ferrari', dhe s'kishte ku ta parkonte. Kështu është kur shet mend me 'Ferrarin' e shokut", - tha moderatori. Kaq mjaftoi që mes- tyre të niste një luftë e ftohtë. Pak orë më vonë Noizy shkroi në Insta- gram se Liço duhet të falënderon- te të dashurën për arritjet që ka.

## ENCA HAXHIA DHE BEATRIX RAMOSAJ

Një foto ironike që këngëtarja kosovare Beatrix Ramosaj postoi në Instagram me të pasmet dhe gjoksin e fryrë me photoshop bëri që të nisë i gjithë konflikti. Në fakt, përshkrimi që Trixa i vuri fotos ishte ai që nxiti sherrin. "Godass" shkruante Ramosaj dhe u mendua se e gjitha ishte një kunj për peshën e Encës, i lidhur dhe me këngën "Call me Goddess". Nuk vonoi edhe përgjigja e këngëtares Enca Haxhia e vulosi armiqësinë mes tyre. "Ishim shoqe derisa të mbyti xhelozia. Por shiko tani sot? Ku je ti? Pa karrierë, pa koncerte, rri në shtëpi tu fol për mu. Xhelozie e pastër edhe tek koncerti i shkollës kur tentoje të sabotoje prezencën time..."- shkroi Enca në një postim.

## JULIAN DEDA DHE GEN- TJAN ZENELAJ

Dyshja e famshme mbahet mend që nga grupi "SHBLSH". Ata të dy nuk ishin vetëm kolegë pune, por edhe miq shumë të mirë. Por lëviz-

jet në karrierë bënë që Juli dhe Genti të mos flisnin më me njëri- tjetrin. Megjithatë i ftuar në "Xing me Ermalin" Juli nxori në njëfarë mënyrë "flamurin e bardhë" të paqes.

## FLORIANA GARO DHE ILDA GEGA

Prishëren e miqësisë së tyre e nxori në pah publikimi i disa foto- ve ku vajzat putheshin në buzë, kur Ilda Gega ishte ende banore e 'Big Brother Albania'. Pas disa vitesh u kuptua që ajo vajza që puthesh me Ildën ishte pikërisht moderatorja Floriana Garo. Ilda, e cila tashmë jeton jashtë vendit u shpreh se Floriana e ka përdorur atë për të arritur famë dhe për të qenë në vëmendjen e mediave.

## ROVENA STEFA DHE BIG MAMA

Big Mama u kap për flokësh me këngëtares e muzikës popullore Rovena Stefa. Ajo u shpreh se Rovi i kishte marrë të dashurin. Artist- nga njëra-tjetra. E pyetur në një in- tervistë, Rovena tha si me ironi, që Stefa është vajzë shumë e mirë dhe s'ka asgjë me të. Kohë e fun- dit ato janë pajtuar pasi Rovena postoi një video në 'InstaStory' duke kënduar këngën e Samantës "Zemrën maje".

## SONI MALAJ DHE OLTI CURRI

Dyshja e famshme u përballën në gjyq për shkak të një fotoje që blogeri postoi në facebook. Olti komentonte pozicionin e dorës së Sonit (e cila kishte prekur organin e saj gjeneral) pasi shkruante: "Nderim Tunës". Por mesa duket Soni dhe Olti kanë bërë paqe pub- likisht. Këngëtarja dhe opinionis- ti janë takuar në një festë në Dur- res. I pyetur nëse i takon edhe per- sonazhet me të cilët nuk flet Curri u shpreh: "Unë flas me të gjithë, madje surpriza e surprizave këtu është Soni Malaj, me të cilën kemi pasur diçka të vogël."

## TUNA DHE NORA ISTREFI

Një nga lajmet më të bujshëm të ditës së djeshme ka qenë padyshim rrëfimi që Robert Berisha bëri në studio- n e Rudina Magjistari. Ky i fundit tregoi për herë të parë se ai dhe Nora nuk kishin qenë pjesëmarrës në 1-vjetorin e Tianit (djalit të Tunës dhe Patrisit) për një shkak të vetëm: ata të dy nuk duan dhe nuk kanë asnjë marrëdhënie me Tunën. "Më vjen keq për Patrisin dhe Tianin, të cilët i dua shumë dhe do jem gjithmonë në gatishmëri për ta, por me Norën nuk duam dhe nuk flasin" - ka thënë Robert Berisha pa e shpjeguar arsyen për këtë. Mirëpo më vonë u zbulua se "molla e sherrit" ka qenë pikërisht fakti se Tuna, në ditëlindjen e vogëlushtit Tian kishte ftuar femijën jashtëmarte se Robert Berishës dhe nënën e fëmijës, duke bërë kështu që Roberti të acarohet aq shumë sa gjithçka ka përfunduar në sherr midis palëve.

**K**a mbetur vetëm një muaj nga lindja e vajzës, ndërkaq Diellza Kolgeci ka vendosur të ndajë një detaj shumë të veçantë. Moderatorja e njohur nga Kosova postoi imazhin 3D të vogëlushes së saj. Tiparet e foshnjës dallohen qartë dhe ndoshta që tani Diellza mund të kuptojë sesi do të duket ajo kur të lindë. Diellza do të mirëpresë vogëlushen me partnerin e saj, basketbollistin Fisnik Rugova, në 10-ditëshin e parë të muajit maj. Ajo është shprehur gjatë një interviste se gjëja që e ka munduar më shumë gjatë shtatzënisë ka qenë pagjumësia. Ajo dhe basketbollisti njiheshin prej shumë vitesh, duke qenë se të dy jetonin në Prishtinë, megjithatë lidhja e tyre e dashurisë nisi vetëm një vit më parë.



**Për një muaj lind, Diellza Kolgeci publikon imazhin e parë të vogëlushes**

**P**as një deklaratë të Arian Çanit në "Zonë e Lirë" për Ronela Hajatin, është vënë re se mes tyre ka një zënkë të pashprehur. Këngëtarja e njohur shkonte shpesh dikur në studion e Çanit për të promovuar hitet e saj, mirëpo tashmë mesa duket nuk do ta shohim më në "Zonë e Lirë". Gjatë lojës që Çani realizon të premtëve në program, "Mix blind test" është vendosur kënga e Ronelës "Vuj", një hit i "Këngës Magjike". Çani menjëherë ka reaguuar duke thënë: "Hiq fare këtë Çerr se s'na intereson, kjo këngëtare është kot fare bo, bo, bo. As nuk e përmend fare cila është, më krijon një kështu ajo mua, nuk e dua jo. Hyn në atë kategorinë e këngëtareve që nuk i ashtu dot fare, më krijon një gjë negative shumë". Pas kësaj deklaratë të Çanit, Ronela ka reaguuar përmes një postimi në "Instastory", ku shkruan: "U prehshin në paqe budallallëqet". Ajo nuk ka vendosur emra sigurisht, mirëpo kjo është marrë si një kundërpërgjigje ndaj deklaratës së Çanit.



**"Është këngëtare koti", Ronela Hajati reagon ndaj deklaratës së Çanit**

**R**udina Magjistari është një nga moderatorët e njohura shqiptare, që çdo ditë të javës është përballë audiencës me formatin që ajo drejton suksesshëm në TV "Klan" prej disa sezonesh. Jo vetëm temat e diskutimit, të ftuarit e ndryshëm në studio, personazhet publikë apo edhe ata të panjohur që bëhen pjesë e studios së Rudinës, gjenden përballë moderatorës që i kthen ata në protagonistë të përditshëm të emisionit të saj. Por, këtë herë ka qenë vetë Rudina që është bërë fokusi i vëmendjes në rrjetet sociale dhe shkak për këtë është bërë thjesht e vetëm një foto. Në fakt, është imazhi me të cilin prezantuesja u shfaq ditën e djeshme në emision, ku fustani në ngjyrë të verdhë dhe rripi i zi i mesit ishin preferenca e moderatorës për stilin e veshjes. Me sa duket, ka pasur një detaj që fansave nuk u ka pëlqyer aspak, ndaj dhe nuk kanë reshtur në komentet e tyre. "Të lutem hiq getat dhe këpucët sepse nuk përputhen as me fustanin dhe as me ty", i thotë një vajzë në komentin e saj, ndërsa Rudina i ka kthyer këtë përgjigje: "E dashur, mos kujto se unë e një departament i tërë, që kuron veshjet e mia, nuk e dinë këtë. Shëndeti është i pari, pastaj veshja", i kundërpërgjigjet moderatorja. Nuk e dimë nëse fansja është bindur pas arsyeve dhe komentit që i ka dhënë moderatorja, por gjithsesi ajo motivet e zgjedhjes së saj i shprehu hapur dhe publikisht.



**"Hiq getat dhe këpucët!", Rudina Magjistari reagon pas komentit të ndjekëses**

**D**itën e nesërme shfaqet filmi i shumëpritur shqiptar "Dy gisht mjalte". Ndërkaq, i ftuar në studion e "Wake Up", në "Top Channel" mëngjesin e djeshëm, Ermal Mamaqi foli ndër të tjera edhe për filmin. Islami e pyeti në lidhje me deklaratën e Ervin Bejlerit se "filmi 'Dy gisht mjalte' është një film komercial, për të bërë lekë dhe kaq". Pak ditë më parë, Bejleri, i ftuar në emisionin "Rreze Dielli" në "Report TV", u shpreh kështu në lidhje me eksperiencën e tij si aktor në "Dy gisht mjalte": "Është një film komercial, është një film për të bërë lekë. Vlera artistike?! Nuk e kam parë ende. Stafit ishte shumë korrekt, si ai teknik, si ai produktional. Është një film komercial, për të bërë lekë, por që për mua, këta filma duhet të prodhohen pse jo? Ka nevojë populli, ka nevojë publiku. Italianët ka vite që bëjnë këto lloj filmash". Mamaqi, që nuk ishte në dijeni të deklaratës, tha në "Wake Up": "Ervin është një djalë shumë i mirë, shumë i talentuar dhe shok i vjetër që nga 'Portokallia'. Nuk e besoj ta ketë thënë me të keq. Fjala 'komercial' në shumë raste duket si diçka e keqe, ka krijuar një lloj imazhi të keq të gjërave që shiten. Kur gjërat shiten, u humbet vlera se njerëzit thonë 'hë se kjo shitet, është komerciale'. Por, kjo s'do të thotë se gjërat komerciale nuk kanë vlera". Ermal Mamaqi dhe Elvana Gjata janë protagonistët e filmit, një komedi romantike që do të lançohet më 28 mars në të gjitha kinematë në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni. Fabula ndërtohet rreth një historie shqiptare dashurie që ka brenda romancën, ndarjen, trishtimin, rillidhjen, dasmën, aventurën, çmendurinë etj.



**"Është film për të bërë lekë", Ermal Mamaqi reagon ndaj deklaratës të Ervin Bejlerit**

# BULEVARDI

## POLITIK

Na merrni seriozisht!

### "Kostumi 300 mijë lekë", Erion Braçe prezanton rrobaqepësin e vet

Erion Braçe shpeshherë provokon me stilin e veshjes së tij, ku pjesë të gardërobës përveç veshjeve sportive, ka edhe kostumet. Kjo për shkak të punës së tij si deputet e aq më shumë tani që mban edhe pozicionin e zëvendëskryeministrit. Pak muaj më parë gjatë një nga debati në Komisionin e Ekonomisë, deputeti demokrat Agron Shehaj ndërsa replikoi me Braçen i tha se kostumi që mbante veshur nuk justifikohet me të ardhurat e tij. Kaq mjaftoi gjatë atij debati që Braçe të revoltohej, duke deklaruar se kostumet ia qepte një stilist shqiptar dhe se nuk kushtonin më shumë se 300 mijë lekë. Sot Braçe na ka prezantuar edhe kush është stilisti shqiptar ku ai vishet. Ai është Adrian Sulo, që ka edhe një studio private në Tiranë. Nga sa shihet në faqen e tij në internet, ai duket vërtetë një mjeshër në qepjen e kostumeve sa edhe shumë njerëz të njohur kostumet e tyre i qepin tek ai.



### Hipur mbi rul, Xhelal Mziu bëhet gati për... zgjedhje?

Pas urdhrimit të Lulzim Bashës për degët e Partisë Demokratike për të nisur përgatitjet për zgjedhje, duket se i pari që ka nisur nga puna për fushatën ka qenë kryebashkiaku i Kamzës, Xhelal Mziu. Te faqja zyrtare e bashkisë ai ka publikuar një foto mbi rul gjatë inaugurimit të një rrugë të saposhtruar. Pak ditë më parë kryedemokrati Basha konfirmoi kandidimin e kryebashkiakut të Kamzës, Xhelal Mziu, për një tjetër mandat, duke theksuar se ai i kishte mbajtur premtimet.



### Ish-ministri bëhet 42 vjeç, dhurata speciale për të

Ish-ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati festoi pak ditë më parë ditëlindjen e 42-të. Në këtë ditë speciale për të dhe familjen e tij, ish-ministri ka marrë urime të shumta, por duket se Bushati ka veçuar njërin prej tyre. Dhurata më speciale është një letër që ia kanë kushtuar ish-ministrit. "Çdo burrë mund të bëhet prind. Të jesh 'baba' e bën dikë më të veçantë", shkruhet në letrën që me siguri ia kanë dhuruar fëmijët, ndërkohë që vetë Bushati e ka cilësuar këtë si dhuratën më të ëmbël për ditëlindje.



### Meghan Markle shpenzoi gjatë shtatzënisë rreth 580 mijë euro

Anglezët kanë llogaritur që shpenzimet që dukeshin e Sussex, Meghan Markle, ka bërë gjatë kohës që ishte shtatzënë janë rreth 580 mijë euro me veshje dhe aksesore. Pallati mbretëror nuk pranon të bëjë shpenzime për veshje dhe mesa duket Harry dhe Meghan i kanë blerë vete veshjet. Veshja më e kushtueshme për Meghan ka qenë fustani bardhë e zi i qëndisur me zogj, i Oscar della Renta, në shitje për rreth 10 mijë euro. Më ekonomikun ka qenë një fustan bezhë i shkurtër i H&M i shitur në pak minuta me shifra të cmendura në 'aBay'. Ato që ka ngritur shifrën finale kanë qenë bizhutë, një pasion shumë i madh i Meghan Markle. Diamantet dhe të tjerë aksesore më gurë të çmuar përbëjnë një të tretën e shpenzi-



Drejtori i "British Council" për Shqipërinë dhe Kosovën shpjegon programin "Shkollat e Shekullit 21"

# Angus Bjarnason: Aftësi themelore për profesionet e së ardhmes të fëmijëve shqiptarë

"Si do të përgatiten nxënësit për profesione që nuk ekzistojnë ende"

Përgatitja e të rinjve për botën e së nesërme nuk ka qenë kurrë kaq sfiduese. Studimet tregojnë që profesionet e së ardhmes do të gjenerohen përherë e më shumë nga sektori i teknologjisë, i cili po krijon role të reja duke kërkuar aftësi të reja. Punëdhënësit kanë kërkesa në rritje për aftësi si mendimi kritik, zgjidhja komplekse e problemeve, kreativiteti dhe aftësia për të punuar në ekupe. Këto së bashku shpesh quhen aftësi themelore.

"British Council" ka projektuar programin "Shkollat e Shekullit 21" për të pajisur 1 milion nxënës të moshës 10-15 vjeç në Ballkanin Perëndimor me aftësitë e nevojshme për të ardhmen e tyre. Programi është financuar nga Qeveria Britanike dhe po zbatohet në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit. Ai do të përfshijë 1,200 shkolla, mbi 4,000 mësues dhe rreth 120,000 nxënës në Shqipëri. Të gjitha shkollave do t'u jepen pajisje BBC micro:bit, të cilat kanë madhësinë e një karte bankare dhe mund të programohen për një larmi zbatimesh të dobishme dhe zbatueshme.

Angus Bjarnason, drejtori i "British Council" për Shqipërinë dhe Kosovën shpjegon për "Gazeta Shqiptare" potencialin e vërtetë të këtij programi.

**"Shkollat e Shekullit 21" është një program sfidues, nisja më e madhe arsimore që "British Council" ka ndërmarrë në Ballkanin Perëndimor. Përse ky theks i veçantë te mendimi kritik, zgjidh-**



Drejtori i "British Council" për Shqipërinë dhe Kosovën, Angus Bjarnason

**ja e problemeve dhe kodimi për arsimin bazë në të gjithë rajonin?**

Revolucioni i katërt industrial po ndodh tani, por ritmi me të cilin vendet e ndryshme po reagojnë mbetet jo i njëjtë. Në Ballkanin Perëndimor dhe shumëkund në botë, vendet ende vuajnë nga mospërputhja ndërmjet sistemeve arsimore dhe kërkesave të tregut të punës dhe të shoqërisë. Kjo shihet si një ndër arsyt kryesore të normave të larta të papunësisë ndër të rinjtë.

Në përgjigje ndaj kësaj

sfide, programi "Shkollat e Shekullit 21" sjell bashkë mendimin kritik me zgjidhjen e problemeve dhe kodimin. Ne synojmë të zhvillojmë një praktikë shkollare në rajon për t'i pajisur nxënësit me aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'u përballur me këto kërkesa të shekullit tonë.

Duke i pajisur 1 milion nxënës në Ballkanin Perëndimor me këto aftësi, po investojmë në të ardhmen e tyre dhe po adresojmë mangësitë e aftësive në një mënyrë të



qëndrueshme.

**- Sakaq, në vendet më të zhvilluara, ekspertët dhe shoqëritë po diskutojnë sfidat e ngritura nga automatizimi i shpejtë, evolucionit marramendës teknologjik dhe sfida të tjera që burojnë nga novacioni. Si mundet që investimi në këto aftësi jotrondionale të shërbejë drejt një të ardhmeje që është më së shumti e panjohur?**

Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (ICT), me një rritje prej 5%-10% në rajon, është një nga fushat me rritjen më të shpejtë të ekonomive në Ballkanin Perëndimor.

Në mënyrë që të nxitet kjo rritje, do të nevojitet gjithmonë faktori njerëzor. Kjo kërkon që punonjësit e së ardhmes të jenë të aftë të analizojnë, mendojnë në mënyrë kritike dhe kreative, si dhe të punojnë në mënyrë bashkëpunuese. Kjo është e ardhmja për të cilën duhet të përgatiten nxënësit e së sotmes.

Programi ynë është i rëndësishëm, sepse sjell bashkë Aftësitë Digjitale (kodim) dhe Aftësitë Njerëzore (mendim kritik dhe zgjidhje e problemeve). Sipas Raportit të së Ardhmes së Profesioneve (Forum i Botëror Ekonomik 2018), pasja e këtyre aftësive do të rrisë në mënyrë të konsiderueshme punësimin në të ardhmen.

**- Shqipëria është një vend ku metodat konservatore të arsimit kanë një histori të gjatë, nga dekadat e diktaturës dhe deri në kurrikulën e sotme, që është subjekt evolucionit të vazhdueshëm. Si arriti "British Council" që të integrojë përcimin e këtyre aftësive në programin ekzistues arsimor?**

Kohët ndryshojnë dhe po ashtu, sistemet dhe politikat arsimore duhet të ndryshojnë. Një vend që nuk mundohet të përmirësojë në mënyrë konstante sistemin e tij arsimor do të mbetet pas nga pjesa tjetër e botës. Duket që Shqipëria e kupton diçka të tillë. Evoluimi i kurrikulës është dëshmi e kësaj qasjeje, siç është edhe gatishmëria për të provuar dhe testuar praktika të reja. Ne kemi ndërtuar një marrëdhënie të shkëlqyer me Ministrinë e Arsimit. Do të punojmë bashkë për t'u siguruar që nxënësit të mësojnë aftësitë që u duhen për të ardhmen dhe do të punojmë me politikëbërësit për t'i integruar tërësisht këto aftësi në sistemin arsimor. Trajnimet që po japim për mësuesit dhe drejtorët e shkollave, si dhe dhurimi për çdo shkollë me pajisje micro:bit, është një investim në të ardhmen e Shqipërisë dhe dëshmi e rëndësishëm i kushtojmë marrëdhënies mes dy vendeve tona.

**- Ju keni pasur një projekt pilot për "Shkollat e Shekullit 21" në vitet 2017 dhe 2018. Cilat ishin rezultatet që ju frymëzuan ta shtrinit në një shkallë të madhe, duke përfshirë të gjitha shkollat dhe mbi 1 milion nxënës në rajon?**

Ky program është ndërtuar mbi trajnimin e Aftësive Bazë të "British Council", të provuar globalisht, si dhe mbi përvojën udhëheqëse të Mbretërisë së Bashkuar në përfshirjen e kodimit në kurrikulën shkollare. Pra, po ndërtojmë mbi përvojën ekzistuese britanike dhe mbi punën e bërë gjatë fazave pilote.

Gjatë viteve 2017 dhe 2018, projekti pilot u zbatua në 135 shkolla në Ballkanin Perëndimor. Rezultatet shënuan një rritje të kuptimit nga mësuesit për rëndësinë e mendimit kritik dhe zgjidhjes së problemeve, ndërsa nxënësit treguan aftësi më të larta në kodim. Gjithkush raportoi për një ngritje të motivimit. Mësimi u bë zbatues.

Dhe mbështetur mbi këtë sukses, vendosëm të punojmë me partnerët tanë të Ministrisë së Arsimit për ta çuar programin në nivelin tjetër dhe duke synuar një ndryshim real dhe domethënës, që do të ndikojë çdo shkollë në Shqipëri dhe në rajon. Kjo është ambicia jonë.

## "SHKOLLAT E SHEKULLIT 21"

Revolucioni i katërt industrial po ndodh tani, por ritmi me të cilin vendet e ndryshme po reagojnë mbetet jo i njëjtë. Në Ballkanin Perëndimor dhe shumëkund në botë, vendet ende vuajnë nga mospërputhja ndërmjet sistemeve arsimore dhe kërkesave të tregut të punës dhe të shoqërisë. Kjo shihet si një ndër arsyt kryesore të normave të larta të papunësisë ndër të rinjtë.

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: RFP - "Mystery shopper: Assessment of performance in central government service delivery 2019"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the aforementioned services.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline set in a sealed envelope, clearly marked UNDP Procurement Notices 54343 - RFP - "Mystery shopper: Assessment of performance in central government service delivery 2019".

For more details please refer to the link below:  
[http://procurement-notices.undp.org/view\\_notice.cfm?notice\\_id=54343](http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=54343)

A pre-proposal conference is scheduled to be organized on Tuesday, 02 April 2019, at 11:00 a.m. at UNDP Offices for all interested companies.

Relevant dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than April 11, 2019, 14:30 p.m.

Address for communications:  
 Email: [procurement.al@undp.org](mailto:procurement.al@undp.org)  
 Or  
 Str. "Skenderbej", Gurten Center (Volkswagen building), 2<sup>nd</sup> floor  
 Tirana, Albania

## FOTOGRAFIA SI ART

# Fillesat e studios "Marubi", oborri si tendë takimi

Fatmira Nikolli

Qe një oborr si gjithë të tjerët, i rrethuar me mure, me pemë e shkurre, e prej ku shihet dera dhe dritarja e shtëpisë, shkalla dhe një parmac me shkopinj. Qe një oborr edhe në kuptimin e një selie ku mund të hynin e rrinin mbreti, princi e bajraktari, por edhe një strehë për katundarin dhe lypësin. Qe një oborr që kishte avantazhin e fotografimit me dritë natyrale. Meqë duhej të rregullohej intensiteti i dritës, ai oborr mbulohej me një cohë që zbuste dritën duke u kthyer në një tendë ku rrihej për një kohë të shkurtër. Për këtë arsye ngjante si "tenda e takimit", një vendtakim për të gjithë, vendas e të huaj që vinin e hynin aty për të takuar veten nëpërmjet Marubit.

Luçjan Bedeni, drejtor i Muzeut Kombëtar të Fotografisë "Marubi" në Shkodër, ka vite që merret me studimin e fillesave të Marubit si studio fotografike. Ambienti ku që vendosur, koha e saktë kur u ngrit, fotografia e parë që u shkrep e jo vetëm, sepse fotografia është një prej arteve me të cilin ne qëmë të njëkohshëm me botën. Së fundmi muzeu "Marubi" ka hapur një cikël bisedat që kanë të bëjnë me dinastinë Marubi. Vendndodhja dhe aktiviteti i studios së parë fotografike të ngritur nga Pietro Marubi në Shkodër ende nuk dihet. Viti 1856 mbetet data e themelimit të studios në Shkodër. Në tekstet e botuara gjejmë të shkruar se studioja e parë e pajisur me mjete të nevojshme të kohës u ndërtua gjatë viteve 1885-1890.

Vetë Bedeni, përmes bisedës "Tenda e takimit e një oborri", sjell kërkimin-hulumtimin e tij për Marubët. Ky hulumtim ka të bëjë me kërkimin e gjurmëve të para të vendndodhjes së studios së Pietro Marubit dhe se si ai kryente aktivitetin; ku ndodhej kjo studio, sa e madhe ishte, cilët qenë "modelët" apo klientët që fotografonte ai. Bedeni ka përzgjedhur disa fotografi, të cilat kanë një lidhje me njëra-tjetrën, për të cilat ai do të japë edhe një shpjegim. Këto takime vijnë pas punëtorisë, "Atëherë dhe tani", që hodhi dritë mbi si pozonin personazhet e Marubit, si vësheshin, çfarë mimikash kishin, çfarë detajesh të tjera vëmë re në kompozimin e imazhit. Punëtorja "Atëherë dhe tani" rimori traditën e vjetër të fotografimit në studion e Marubëve duke e risjellë atë me personazhe të kohëve tona, po aq autentike sa ata të Marubit.

## GIJURMË TË PAFSHIRA

Studio "Marubi" sipas studimit të Bedenit përfshinte një mjedis prej 5 x 7 m të pozicionuar në kahun verilindor. Dy të tretat e pullazit dhe e tërë fasada ishin prej xhami, me qëllim që drita të hynte në sasi



Një cikël bisedash në Muzeun Kombëtar të Fotografisë

Hulumtimi i Luçjan Bedenit për gjurmët e pafshira

të barabartë, si nga sipër ashtu edhe anëve. Xhamat mbulohehin me perde të mëdha bezeje, që lëviznin sipas nevojës për dritë. Aparatet e para fotografike që përdoren qenë me përmasa 30 x 40 cm të markave franceze e gjermane me kasetë për dy negativë 26x31 dhe 21x27 cm. Fotografimi me këtë aparat bëhej në hije, në natyrë. Më vonë hyri në përdorim aparati me përmasat 18x24 e 13x18 cm, i mbështetur në trekëmbështa druri. Bedeni shënon se studio fotografike "Marubi" nuk prodhoi

vetëm për nevojat personale apo familjare të qytetarëve. Fotografitë me interes etnografik, historik apo gjeografik ilustruan me dhjetëra vepra të autorëve të huaj për Shqipërinë, ose u botuan në trajtën e

kartolinave. "Fotografitë e saj janë një pasuri të rrallë për historianët, etnografët, arkitektët, urbanistët, artistët, etj.

Grupe patriotësh, bajraktarë e kryengritës, përfaqësues të Komit-

sionit të Kufijve, delegatë e politikanë, gra e burra me veshje qyteti, fshati e malësie, pozonjë të gjithë brenda një oborri shkodoran. Krerët e Mirditës të ardhur në Shkodër me rastin e vdekjes së Bib Dodës pozonjë tek i njëjti oborr me kalldrëm e mur me gurë Kiri. Nga një kënd tjetër pozonjë dhe Marsh Uci e t'bijt e Calit", shënon ai. Më tutje vëren se gjejmë në këto dy foto të njëjtën skenë, por me kënd fotografimi të ndryshëm. Personazhet pozonjë veçmas e bashkë përballë fotografit, që me stativin e tij të fiksuar në një vend lëviz vetëm këndin e objektivit të tij në oborr. Në njërin prej fotografive, atë të parën, dritarja është thuarje në profil, ndërsa tek e dyta është në mes e përballë. "Pas dritares shikojmë derën që përsëritet në dy foto e më pas në vazhdimin e të gjithë imazheve tjera gjejmë të përsëritet cepi i një shkalle. Gjithashtu, po të futemi në brendësi të këtyre fotografive ndjejmë gjurmët e stinëve prej veshjes së njerëzve si dhe prej gjendjes, pranisë apo mungesës së gjetheve të pemëve. Por nga kjo kuptojmë që fotografi e paska përdorur këtë oborr për një kohë të gjatë duke fotografuar personazhe, të cilët i vendos herë ulur e herë në këmbë,

herë mbështetur në një gurë e herë në një pod", thotë Bedeni. Sipas tij, çdo njëra prej këtyre fotografive mbetet shumë interesante për të analizuar se si fotografi e shndërron oborrin në një skenë ku im-provizon shkrepjen e fotografive të tij. Duke parë fotografitë, veç subjekteve që pozonin, njëkohësisht hedhim vështrimin rrotull oborrit. "Ndër këto imazhe të bën përshtypje fotografia e Mati Kodhelit, një ndër të rrallat e gjendura në arkivë. Ky imazh mbetet i veçantë për faktin se dallohet ndërhyrja e fotografit që kujdeset për çdo detaj. Nga sa kuptohet, poza është marrë në një ditë të ftohtë sepse pemëve u kanë rënë gjethet. Fotografi është kujdesur që gardihi ku do të pozonjë personi të jetë sa më i plotë me drurë e rrënjë të marra nga diku tjetër. Por, më interesante aty është marrëdhënia me dritën. Në të majtë shikojmë një mekanizëm ingranazhesh, e cila lart komandon një tendë që zbut dritën e fortë dhe kontrastet e vrazhda duke e kthyer atë oborr nga eksterier në interior", ndalet Bedeni në hulumtimin e tij. Imazhet e përzgjedhura ofrojnë një version të besueshëm të kontekstit të realizimit të fotografive të para të Marubit. Ato mbase na sugjerojnë se e gjithë kjo histori filon nga një oborr karakteristik shkodoran, që ishte skena ku erdhën e pozuan subjektet e ndryshme.



## DEBATI



Teatri i Kukullave kur ishte parlamenti i parë shqiptar



Teatri i Kukullave brenda dhe jashtë sot

# "Nuk e lejojmë shembjen e Teatrit të Kukullave"

Fatmira Nikolli

Pas deklaratave të kryeministrit të vendit ditën e shtunë për Teatrin e Kukullave, Bibliotekën Kombëtare dhe Muzeun Historik Kombëtar, ka reaguuar skena artistike. Përmes një deklaratë, Skena e Pavarur Kulturore (SPK - një rrjet që përfshin organizata kulturore aktive në fushën e artit dhe kulturës) dënon atë që e quan retorikë negative, anakronike, antiligjore dhe antikulturore të kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në një aktivitet elektorale të zhvilluar të shtunën, më 25 mars në Tiranë. Sipas SPK-së, atë ditë, në emër të vetëlavdërimit dhe në përpjekje për të shmangur diskutimin mbi shkeljet e panumërtat ligjore të atij vetë në menaxhimin e pronës publike dhe trashëgimisë kulturore, paralamëroi shembje të ndërtesave kryesore historike të qendrës së Tiranës, të tilla si Teatri Kombëtar, Teatri i Kukullave apo Muzeu Historik Kombëtar. Skena e Pavarur Kulturore gjykon në deklaratë se kërcënimet e kryeministrit për shkatërrimin e një pjese thelbësore të trashëgimisë kulturore dhe historike të Tiranës nuk janë gjë tjetër veçse fjalë boshe. Ai nuk e ka shembur deri tani Teatrin Kombëtar jo se nuk ka dëshiruar ta shembë, por sepse deri tani nuk ka guxuar të vë në zbatim paligjshmërinë dhe antikushetshmërinë e planit të tij fillestar të koncesionit "Fusha". Siç mund ta ketë kuptuar, vetë kryeministri, projektligji i tij personal "Fusha" ka skaduar tashmë prej muajsh pa rezultat. Afati i vënë në ligj për "mbylljen e negociatave me kompaninë Fusha" brenda një muaji nga hyrja në fuqi e ligjit, ka skaduar shumë muaj më parë. Ashtu si me koncesionet e tjera personale të kryeministrit,



Teatri i Kukullave brenda dhe jashtë sot



Teatri i Kukullave brenda dhe jashtë sot

## Skena e Pavarur Kulturore dënon deklaratat e kryeministrit

edhe ky nuk ka ecur përpara jo për mungesë dëshire, por për shkak të frikës se kjo shkelje ligji mund të bëhet nga rastet e para në historinë e re të Shqipërisë, që përfundon me dënim të shkelësve.

Skena e Pavarur Kulturore gjykon se protesta e vazhdueshme e Aleancës për Mbrojtjen e Teatrit dhe sakrificat e aktivistëve në mbrojtje të teatrit dhe rrjedhimisht, të shtetit ligjor, ka dhënë frytet e veta duke ndaluar një shkelje flagrante të ligjeve dhe të Kushtetutës. Për rrjedhojë, Skena e Pavarur Kulturore mendon se Teatri i Kukullave, një ndërtesë me rëndësi historike për shkak se ka qenë parlamenti i parë, (e ndoshta i fundit) me të vërtetë demokratik në historinë e Shqipërisë, ashtu si edhe ndërtesat e tjera të kërcënuara nga Rama, mundet të shembur nga ndonjë tërmet, mundet t'i bjerë zjarri apo të rrënohen nga neglizhenca flagrante e autoriteteve. Por, shanset e Ramës për të shembur këto ndërtesa janë zero. Ne do të ndalojmë kryemi-

nistrin dhe çdokënd që mendon ndryshe nga shkatërrimi i trashëgimisë sonë historike dhe kulturore për llogari të pazareve të radhës me klientët e radhës.

**ÇFARË THA KRYEMINISTRIT**

Më poshtë mund të gjeni transkriptin e deklaratës së kryeministrit.

"Sheshi 'Skënderbej' sot është një kryevepër urbanistike, e konfirmuar ndërkombëtarisht, e cila i bën Shqipërisë shërbime të mira duke i dhënë asaj çmime, komplimente dhe foto të pafundme nga vizitorët. Por, Muzeu Historik është ende një fantazmë e së shkuarës m'u në mes të sheshit. Opera është në kantier dhe fatmirësisht këtë vit do të rihapë dyert dhe do të tërheqë shumë më tepër vizitorë në qenien e saj tërësisht të rillindur. Por në krah të saj Biblioteka Kombëtare është i madhi i munguar në transformimin tonë të derikëtushëm.

Teatri i Kukullave është një karakterin që na turpëron përpara fëmijëve tanë. Uroj dhe besoj që deri në fund të këtij mandati

qeverisës ne do t'i hapim themelet e Bibliotekës së re Kombëtare dhe teatrit të ri të fëmijëve, këtu pranë të Gardës, ndërsa në mandatin e ri të Erionit do t'i hapim edhe dyert e këtyre dy institucioneve. Nuk harroj Teatrin e ri Kombëtar, të cilin do ta ndërtojmë se s'bën dhe për turpin e të gjithë atyre që e kanë baltosur pa lindur projektin tonë, le ta bëjmë teatrin e ri kombëtar një kryevepër të konfirmuar ndërkombëtarisht ashtu si 'Qemal Stafën' e vjetër, 'Arenën e Re Kombëtare', deklaroi Rama. Për këtë deklaratë të Ramës, Skena e Pavarur thotë se kjo politikë është në vazhden e degradimit të trashëgimisë dhe mungesës së vullnetit të institucioneve përgjegjëse, që nuk ndër marrin asnjë veprim për ta mënjauar këtë t'rezik.

"Skena e Pavarur Kulturore është solidarizuar që në fillim me kauzën e mbrojtjes së Teatrit Kombëtar për mos lejuar shkatërrimin e Teatrit Kombëtar dhe shkeljen e Kushtetutës së vendit. Njëlloj sikurse ka ndodhur në rastet e Velierës, Butrintit, Teatrit Kombëtar dhe në të gjitha rastet ku z. Rama ka ndërhyrë me qëllim që njerëz të afert me të dhe pushtetin e tij të përfitojnë financiar-

isht, (mjaftojmë të sjellim në vëmendjen e publikut Nenin 172 të Ligjit për Trashëgiminë Kulturore që shkon pikërisht në këtë drejtim)", thuhet në deklaratë. Më tej shtohet se SPK do të kundërshtojë fuqimisht nëse do të kanoset prishja e Teatrit Kombëtar, Teatrit të Kukullave (ish-sella e Parlamentit Shqiptar), Muzeut Kombëtar dhe Biblioteka Kombëtare. SPK do të mobilizojë qytetarët dhe shoqërinë civile për ta kundërshtuar ashpër një gjë të tillë. "I kujtojmë z. Rama se shteti ka për detyrë ta mbrojë trashëgimisë kulturore, sepse ajo është e lidhur ngushtë me vazhdimësinë historike të shoqërisë dhe identitetin e vetë kombit. Elementi i shtetformimit duhet t'i motivojë njerëzit t'i ruajnë objektet e trashëgimisë kulturore. Njëlloj si shtetet europiane, si Franca, Britania e Madhe dhe Gjermania, të cilat trashëgiminë kulturore e shohin si element kyç për krijimin e identitetit të përbashkët shoqëror dhe shtetformimin e shtetit, edhe qytetarët shqiptarë duan që godinat historike si pjesë e qenësishme e trashëgimisë kulturore të ruhen si pjesë e kujtesës dhe identitetit të kombit", e mbyll reagimin SPK-ja.

Opinion i Ditës

# A duhej ta linte shtetësinë shqiptare djali i Bujar Nishanit!

Nga Dritan Hila

(vijon nga faqja 1)

... ideologjikisht atë.

E veçanta e tij është se nuk vinte nga shtresat armiqësore me komunizmin. Përkundrazi, babai i tij Boleslav Gebert, me prejardhje nga një familje të mirëqenë ishte komunist me aktivitet në SHBA dhe themelues i PK-së amerikane, ideolog i komunizmit polak, dhe funksionar i lartë i tij dhe ambasador për periudha të gjata në SHBA dhe Turqi.

Kur e pyetën një herë Kostantyn se, si ka mundur që një fëmijë nomenklature u bë varrmihësi i saj, ai u përgjigj: "Duhet pyetur babai im se, si nga pinjoll i borgjezisë polake u bë shkatërrues i saj." Nuk ka shpjegim më genuin për marrëdhëniet etër-bij dhe irracionalitetin e natyrave njerëzore. Berlingueri, ish-shefi i komunistëve italianë thoshte se,



kontradikta e fundshekullit të 20-të ishte ajo mes brezave. Shkak për këtë gjykim protestat studentore të vitit '68.

Rasti i djalit të Bujar Nishanit nuk ka asgjë dramatike. Deri

më sot askush nuk e ka dëgjuar si fëmijë problematik. Por edhe nëse do të ishte i tillë, nuk ka gjë më normale mes fëmijëve dhe prindërve. Bujar Nishani mund të jetë patriot dhe fëmija i tij glo-

balist; babai mund të jetë demokrat i thekur dhe djali i majtë i bindur; i ati mund të jetë armik i Edi Ramës sikurse i biri fans i tij. Statistikat thonë se 20% e fëmijëve madje votojnë ndryshe

nga prindërit. Asgjë jo normale nuk do të kishte në kundërshti, ashtu sikurse asnjë çudi nëse biri të ndajë të njëjtin mendim me babanë.

Si maxhoren, djali i Bujar Nishanit ka të drejtë të bëjë çdo zgjedhje, përfshirë lënien e shtetësisë. Kjo nuk e bën antishqiptar. Dhe as është një akuzë indirekte që babai i tij ka bërë një Shqipëri të keqe. Në këtë Shqipëri që kemi, jemi të gjithë aksionarë dhe të gjithë kemi hequr dhe vënë tulla. Aq më pak mund ta akuzojnë të majtët për rebelim, kur rebelimi ndaj etërve është në ADN-në e së majtës. Nëse djali i Nishanit do të kishte bërë një akt korruptiv apo me dëm social, do të ishte i kuptueshëm sulmi ndaj tij. Në të kundërt, merruni me babanë që ka marrë përsipër edhe kostot e luftës politike. Por lërimi të qetë një djalë të ri që thjesht kërkon të ndërtojë jetën e tij ashtu siç i pëlqen, si austriak apo shqiptar.

Dritare.net

## BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE.  
LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA,  
ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE  
LAJMET E FUNDIT NE  
APARATIN TUAJ



INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

BalkanWeb.com  
**BW**

FALAS



Dje në 'Project Syndicate'

# Ambicia që i nevojitet Europës

Nga Dominique Moisi

(vijon nga faqja 1)

... së tij - të përshkuara në një koment të publikuar në të njëjtën kohë në të gjitha vendet e Bashkimit Europian - ishin kryesisht pozitive, madje edhe me kryeministrin euroskeptik të Hungarisë, Viktor Orban dhe Liviu Dragnean e Rumanisë, duke miratuar axhendën e tij (për arsye taktike). Por, në mes të të gjithë këtij miratimi, një zë i dukshëm mungonte: Gjermania.


Anegret Kramp-Karrenbauer (e njohur si AKK) - udhëheqësja e re e Unionit Kristian Demokratik dhe pasardhësja e mundshme e Angela Merkel si kancelare e Gjermanisë - beson se vizioni i Macronit është tepër ambicioz dhe jo mjaftueshëm pragmatik. Përgjigja e saj ndaj platformës së tij në mënyrë implicite sfidoi angazhimin e Francës për një Europë më të centralizuar.

Së pari, ajo mbështet idenë që BE-ja të ketë një vend të përherëshëm në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara - një privilegj që, në Europë, aktualisht e gëzon vetëm Franca dhe Mbretëria e Bashkuar. Së dyti, ajo theksoi nevojën për "heqjen e anakronizmit", duke përfshirë edhe mbajtjen e takimeve të Parlamentit Europian vetëm në Bruksel, në vend që të vazhdojë të mbajë seanca mujore në Strasburg.

Por, nëse ka ndonjë anakronizëm po dëmton Europën, ai është angazhimi i Gjermanisë ndaj status quo-së. Përtej disa ideve për atë që Franca mund të sakrifikojë për Europën, propozimet e AKK-së nuk sollën asgjë të re në tryezë - sigurisht që nuk kishte asnjë idë për atë që mund të ofrojë në këmbim Gjermania. Siç më tha një mik gjerman, i cili luajti një rol të rëndësishëm politik në vendin e tij në vitet 1990: "Ka shumë ide në anën franceze dhe shumë pak në atë gjermane".

Çfarëdolloj arsyeje të përbashkët mund të ketë ekzistuar midis Francës dhe Gjermanisë më parë, ajo tashmë i ka lënë vendin një ndarjeje. Kjo është një përplasje jo vetëm e personaliteteve apo edhe e domosdoshmërive politike, por e nostalgjive: Franca dëshiron madhësinë e epokës Charles de Gaulle, ndërsa Gjermania kujton me dashamirësi stabilitetin e rehatshëm të Republikës së Bonit.

Në shtator 1989 - pak para rënies së Murit të Berlinit, kur komunizmi evropian tashmë kishte filluar të shpalojë - mora pjesë në një konferencë në Frankfurt, ku i thashë një audience bankierësh gjermanë se brenda pak vitesh Europa dhe Gjermania do të të ribashkoheshin. Mosmiratimi i tyre ishte i duk-



shëm. Edhe nëse bashkimi ishte i mundur - nuk kishte gjasa, në sytë e tyre, pasi Bashkimi Sovjetik nuk do të pranonte kurrë - pse do të donte dikush të rrezikonte me historinë, duke ndryshuar një politikë që po funksiononte aq mirë, të paktën për Gjermaninë Perëndimore?

Ndërsa Gjermania ankohet për humbjen e stabilitetit të saj të rehatshëm, Franca mendon se nostalgjia e saj për madhësinë po përmbushet. Franca nuk mund ta rimarrë e vetme lavdinë e saj të mëparshme. Por, si një udhëheqëse e BE-së, ajo mundet. Çelësi është që Europa të mbetet ambicioze - një domosdoshmëri që fiksimi i Gjermanisë me status quo-në vazhdon ta pengojë.

Çështja, natyrisht është se cili vend po mbështet një qasje që i shërben Europës në tërësi. Përgjigja është e qartë: Franca.

Në një kohë kur Shtetet e Bashkuara po përqafojnë izolacionizmin, Europa nuk mund të mbështetet më te parteri i saj më të rëndësishëm ndërkombëtar. Ndërkohë, lojtarët që po

(ri)lindin, sidomos Kina dhe Rusia, po punojnë shumë për të ndërtuar fuqinë dhe ndikimin e tyre.

Në përgjigjen e saj ndaj Macronit, AKK duket se i njeh sfidat që nënkupton kjo gjë. Ajo pyet, për shembull, "a duam ne që e ardhmja jonë të përcaktohet nga vendimet strategjike të Kinës apo Shteteve të Bashkuara, apo duam të luajmë një rol aktiv në formësimin e rregullave të bashkëjetesës së ardhshme globale?"

Ajo që AKK nuk arrin të kuptojë është se një Europë ambicioze ka një shans shumë më të mirë për të konkurruar në këtë mjedis sesa një Europë e amullt. Në këtë kuptim, Gjermania, dikur nxënësja më e mirë në klasën europiane, po sillet si anëtarja e saj më përtaçe dhe më kokëfortë.

Për afro 30 vjet, evropianët kanë kërkuar një narrativë të re, një që është më pak për t'i rezistuar negatives sesa për të mishëruar pozitiven. Liderët e Europës e kërkuar këtë tek integrimi. Në kohën kur BE-ja zëvendësoi Komunitetin Ekonomik Europian në vitin 1993, qëllimi i Europës ishte

të krijonte evropianë, të bashkuar nga vlerat, interesat dhe deri në një farë mase identiteti.

Programi Erasmus, i krijuar në vitin 1987, supozohej ta çonte përpara këtë qëllim. Në një darkë ku mora pjesë në mesin e viteve 1990, kancelari gjerman Helmut Kohl ishte entuziast për planin. Ai besonte se shkëmbimet nga të rinjtë - ndarja e ideve dhe kulturave, së bashku me picën dhe birrën - do të krijonte një brez evropianësh. Ata do të krijonin familje europiane, me fëmijë evropianë. Lufta midis tyre do të ishte e pakonceptueshme.

Pothuajse tri dekada më vonë, Europa mund të mos kthehet dot nga e para pas këtij dështimi, por sigurisht që po bën pas. Ndërsa Europa e viteve 1950 ishte e dëshpëruar për të siguruar paqe dhe liri, e mbështetur nga sisteme dhe vlera liberale demokratike, Europa e vitit 2019 po zgjedh partitë nacionaliste dhe populiste, të cilat po e dëmtojnë në mënyrë aktive atë përpjekje. Ky nuk është një status quo që dikush duhet ta mbrojë.

Marrë nga "Express"

## HOROSKOPI

### DASHI

Të lindurit e kësaj shenje do të vendosin këtë të mërkurë nëse do të shmangin rutinën, ose nëse do të përpigjen të eliminojnë vështirësitë me të cilat do të përballen. Tregohuni të kujdesshëm dhe mos e thyeni ligjin.

### DEMI

Mos neglizhoni këshillat e personave tuaj të afërt, mbi të gjitha rekomandimet nga persona me një shumë eksperiencë se ju. Shmangni shakatë e papërshtatshme dhe alkoolin. Në mbrëmje mund të përfshihen në punët e shtëpisë.

### BINJAKET

Rrezikoni të humbni kontrollin e emocioneve gjatë kësaj të mërkure. Nuk rekomandohet të eksperimentoni me stinë të veshurit. Në mbrëmje mund të mësoni diçka të re në familjen tuaj. Beqarët e kësaj shenje ka gjasa të zhgënjehen nga një marrëdhënie e mundshme romantike.

### GAFORJA

Gaforret kanë çdo shans për të pasur një ditë produktive. Mos lejoni që depresioni, pasiguria dhe pesimizmi të ndikojnë në planet tuaja. Mos dilni menjëherë në përfundime, nëse nuk jeni dakord me sjelljen e një prej të afërmeve tuaj.

### LUANI

Luanët nuk duhet të shmangin kompromiset sot. Dëgjoni mendimin e kolegëve, të afërmeve dhe miqve. Ka gjasa që disa prej tyre t'ju japin idetë të vlefshme. Mund të takoni dikë me të cilin keni mjaft kujtime nga e kaluara.

### VIRGJERESHA

Mos i kushtoni më shumë rëndësi pushimit se punës. Filorja që do të arrihi do të jetë shumë emocionuese për ju, mbi të gjitha nëse jeni përpjekur shumë për ta arritur atë. Do të jeni shumë energjikë, çfarë do t'ju ndihmojë që të përballoni volumin e madh të punës.

### PESHORJA

Disa Peshore do të zhvillojnë disa takime shumë të dobishme. Ka gjasa që duke pasur prioritet marrëdhënien tuaj romantike, biznesi dhe karriera të kalojnë në vend të dytë. Nuk parashikohen konflikte apo probleme gjatë kësaj të mërkure.

### AKREPI

Për disa Akrepa detyra kryesore do të jetë kërkimi i një stili të ri veshjeje. Ka gjasa që të bëni edhe ndryshime në sjelljen tuaj, por rezultati i eksperimenteve të tilla nuk dihet. Do të ishte e udhës të përqendrohesh në çështje më serioze.

### SHIGJETARI

Shigjetarët mund t'ju befasojnë me shpejtësinë e tyre sot. Ka gjasa që brenda kësaj dite t'ju duhet të realizoni shumë punë dhe të merrni vendime të rëndësishme për fatin e karrierës suaj. Pasditë do të jeni kohë mjaftueshëm për t'u relaksuar.

### BRICJAPI

Bricjapët rrezikojnë të mbeten pa fjalë këtë 27 mars. Kjo mund të vijë si pasojë e një problemi personal. Rekomandohet të flisni hapur me njerëzit tuaj të ngushtë, pasi do të ndikojë mjaft mirë në gjendjen tuaj psikologjike.

### UJORI

Ujorët nuk do të jenë lehtësisht të kuptueshëm sot. Gjendje juaj emocionale do të ndryshojë shpesh. Nuk është dita e duhur për të zhvilluar negociata të rëndësishme apo për t'u fokusuar te çështjet financiare.

### PESHQIT

Peshqit nuk do të përballen me probleme gjatë kësaj të mërkure. E vetmja gjë që mund t'ju shqetësojë paksa është pagujmësia. Bisedat e hapura me miqtë e ngushtë janë të mirëpritura. Madje, njëri prej tyre përveçse mik, mund të shndërrohet edhe në partner në biznes.

**KOMBËTARJA U21**

Një gol i vonë i Sulës ka shpëtuar nderin e 21-vjeçarëve të Shqipërisë përballë Andorrës në një takim që përfundoi me rezultatin 2-2, por që edhe njëherë tregoi limitet e mëdha të kësaj grupmoshe, e cila edhe njëherë dështoi të marrë tre pikët e para në grup pas takimit të humbur 2-1 ndaj Turqisë. Në minutën e 19-të vendësi kalojnë në avantazh me anë të Alaez me

**Shqipëria për faqe të zezë në Andorra, veç barazim**

Shqipërinë që shfaq limite të theksuara në mbrojtje. Pjesa e parë mbyllet me fitoren e vendësve, ndërsa me fillimin e së dytës, kuqezinjët do të barazojnë në të 53-ën me Omerin. Duket se Shqipëria e Alban Bushit më në fund është në rrugën e duhur, por vetëm 2 minuta më pas, An-

dorra shënnon sërish me Alaez, sërish pas një gafe në mbrojtje të 21-vjeçarëve tanë. Kuqezinjët luajnë rrëmujshëm, nuk krijojnë asgjë dhe i shpëtojnë humbjes skandaloze në minutën e 86-ët, kur Din Sula bën të mundur që Shqipëria U21 të marrë pikën e parë në grup.

**DËMTIMI NË MUSHKËRI**

Partizani ka njoftuar se ditën e djeshme mesfushori vlonjat Bruno Telushi, i është nënshtruar ndërhyrjes kirurgjikale në mushkëri pas dëmtimit që pësoi të dielën e shkuar në ndeshjen kundër Teutës. Mesfushori pësoi një pneumotoraks pas përplasjes me Prognin, ndërsa u shtrua me urgjencë në spital pas dëmtimit të pleurës së mushkërisë. "Ka përfundu-

**Operohet Bruno Telushi, ndërhyrja del me sukses**

ar me sukses ndërhyrja kirurgjikale në mushkëri për Bruno Telushin. Përgjatë gjithë këtyre ditëve titullari i ekipit ka qenë në kujdesin e stafit mjekësor të spitalit Amerikan, të cilët pasi kanë monitoruar gjendjen e tij shëndetësore kanë vendosur

të bëjnë një ndërhyrje në mushkëri. Falë këtij operacioni, i cili ka rezultuar i suksesshëm koha e rikuperimit të Telushit pritet të jetë më e shpejtë nga sa parashikohet dhe tashmë mesfushori i kuq do të ndjek një program të veçantë".

Jeton Selimi



Vuante nga një sëmundje e rëndë. Në karrierë luajti për Villazninë dhe Partizanin

**Futbolli qan një kolos, lamtumirë Ali Mema!**

*Ikona e Tiranës ndahet nga jeta në moshën 76-vjeçare*



shkurt të vitit 1943, ndër-s talentin e tij e zbuloi mjeshtri Xhavit Demneri, që e aktivizoi me moshat e klubit bardheblu, ndërsa në vitin 1960, vetëm 17 vjeç, do të kalonte me ekipin e parë të 17 Nëntorit, ku do të luante deri në vitin 1966, për të kaluar më pas për dy sezona te Villaznia e Shkodrës. Në vitin 1968 do të rikthehet tek ekipi i tij i zemrës, teksa në sezonin 1970-1971 do të përfaqësojë Partizanin në Kupën Ballkanike. Lojtar polivalent, pavarësisht se vetëm 172 centimetra, do të ishte shumë i fuqishëm në luftën në ajër, ndërsa luante mjaft mirë me të dyja këmbët. Tifozët

e Tiranës e adhurorin, kundërshtarët e respektonin. Kurrë nervoz e banal, gjithnjë i edukuar në fushë e jashtë, Mema do të varte këpucët në gozhdë në vitin 1972, vetëm 29 vjeç, do të veshë tutat e trajnerit dhe deri në vitin 1987 do të jetë trajner i dytë i 17 Nëntorit. "Mjeshtri i Madh" dhe "Legjenda e Futbollit Shqiptar" nga sot nuk do të jetë më mes nesh, por vepra e tij në fushën e lojës e ka gdhendur emrin e Ali Memës në përjetësi. Homazhet në nderim të Ali Memës do të zhvillohen sot nga ora 10:00-12:00 në ambientet e stadiumit "Selman Stërmasi".

**GATI RINOVIMI**

Napoli, kontratë milionere për Elseid Hysaj

Mbrojtësi shkodran i Kombëtares shqiptare, Elseid Hysaj, është fare pranë rinovimit me klubin e tij, Napoli. Pas një fillimi të vështirë pas ardhjes së Karlo Ancelotit në krye të stolit të klubit të kaltër, Hysaj ka rifituar sërish vendin e tij në formacionin titullar dhe tashmë duket se mbrojtësi dhe drejtuesi kanë gjetur "feeling"-un që u mungonte prej kohësh. Sipas mediave italiane, 25-vjeçari është pranë rinovimit të kontratës, dhe përveç kohëzgjatjes, pritet dhe një rritje e ndjeshme e pages. Agjenti i lojtarit, Xhufredi, ka kërkuar një rrogë prej 3 milionë eurosh në sezon, ndërsa Napoli duket se do të ndalet në 2.5 milionë euro, që gjithsesi do ta shndërronin Hysajn ndër lojtarët më të paguar në ekip.

**Presidenti vlerëson kandidaturat**

Duka nuk nxitohet, ja lista e plotë e emrave për stolin kuqezi



"këshilltarët" e Dukës e afrojnë gjithnjë De Biasin me futbollin shqiptar, fundja me të drejtë pasi është trajneri më i suksesshëm. Edi Reja. E nisim nga i pari dhe më i kuotuari, Edi Reja. Ish-trajneri i Lazios, Napolit,

e shumë ekipëve të tjera ka pranuar publikisht se ka pasur një ofertë nga drejtuesit e Federatës, thjeshtë mori më shumë kohë për të marrë një vendim final. Vetëm detajet ekonomike mund të largojnë Rejan nga stoli kuqezi.


Lojtarët kërkojnë që pasuesi i Panucit të jetë italian, të gjithë ndihem me komod me një "azzurri" në stol, madje dhe vetë Duka, dashuria e tij për teknikët italian nuk është më një sekret. Nëse dështon pista Reja, alternative mbetet dhe dy ish të famshëm, Luigi De Canio, i pa punë që nga janari pasi u shkarkua nga Ternana dhe një emër "big" si Roberto Donadoni, ish lojtar i famshëm i Italisë, ish trajneri i shumë ekipëve në Serie A dhe mbi të gjitha i përfaqësueses Italiane, për Shqipërinë, Donadoni do të ishte një luks. Në sytë e Armand Dukës aktualisht është ende herët që një trajner shqiptar të marrë drejtimin e Kombëtares, pavarësisht se Bulku bëri mirë, emri i vetëm që e josh ndër vite është ai i Besnik Hasit. Në pritje për të vendosur se kush do të jetë trajneri i ri, BalkanWeb mëson se Armand Duka nuk është i "disponueshëm" këto ditë.

**UEFA ka gati ndëshkimin**

Racizmi ndaj Stërling, Mali i Zi rrezikon shumë

Anglia fitoi 5-1 kundër Malit të Zi. Një sukses neto, Apor rezultati ka dalë në plan të dytë dhe të gjithë flasin për racizmin me të cilin lojtarët me ngjyrë të skuadrës britanike u përballën në stadiumin e Podgoricës. Mediat angleze kanë nisur menjëherë sulmin, duke cituar si fillim trajnerin Gareth Southgate, që menjëherë pas ndeshjes ka kërkuar nga delegatët e UEFA-s të shënojnë në protokoll koret raciste të tifozëve vendas. "E gjithë kjo nuk mund të pranohet. Ne presim që UEFA të marrë masa", ka thënë tekniku. Edhe dëshmitë e "viktimave" si Danny Rose, Hudson-Hoddoi apo Stërling janë drithëruese. "Sa herë preknim topin, tifozët në tribuna bënin si majmunë", është shprehur sulmuesi i Çelsit. Pasi rrefejnë atë që përjetuan lojtarët në fushë, mediat në Angli bëjnë të ditur se vendimi më i drejtë do të ishte tërheqja e skuadrës dhe bojkotimi i sfidës. Edhe kritikant ndaj UEFA-s nuk kanë doza më të pakta. "Lojtarët duhet të mbrohen. Mali i Zi mund të dënohet me gjobë dhe asgjë nuk do të ndryshojë. Duhen penalizime më të rënda", shkruan "Daily Telegraph". Ndërkohë, edhe qeveria europiane e futbollit ka njoftuar nisjen e një hetimi disiplinor në dëm të Malit të Zi, që rrezikon të luajë pa tifozë deri në fund të këtyre eliminatorëve.

**Fjalëkryqi (1)**



**HORIZONTAL**

1. Eshhtë babëzia.
8. Burton regjisor.
11. Skllavja e Abrahamit.
12. Një dite në mbledhje.
14. Tyson i boksit.
15. Rrethojnë ringun.
17. Beson pa kufij.
19. Zola që shkroi Nana.
20. Eshhtë ankimim.
23. Pak elementarë.
24. Janë me para në bankë.
26. Matet pa kufij.
27. Janë ngrehina për reparte fabrikash.
28. Një zog i verdhë.
29. Inicialet e Moravia-s.
31. Qytet gjerman.
34. Një zonjë që ha gurë.
35. Pak analogji.
36. I ka plasur të paturpiti.
37. Janë legjendat.

38. Nuk ka akoma një bebe.
39. Fillojnë mirë.
40. Janë brinjë në skuadër.
42. Shkruhet i shtati.
44. Nget edhe ajo e mirë
47. Mbahet në gisht.
48. Janë numrat 1, 3, 3...

**VERTIKAL**

1. Kanë shpate të tilla.
2. Janë edhe ato polare.
3. Janë mizorët.
4. Janë male në Rusi të tilla
5. Eshhtë nusja me vello.
6. Një rreth pa ekstreme.
7. Mbyllin kuvendin.
8. Në kryt të titujve
9. Diku në qendër.
10. Markë cigaresh.
13. Janë rrefimet e të pandehurit.
14. Janë penjtit për gjerçef.
16. Mbarojnë fare.
18. Janë stitët e... provimëve.
20. Mund të jenë fotografikë të tillë.
21. Vitet pa kufij.
22. Një fjalë për tutje.
24. Brown i Kodi i Da Vinci-t.
25. Eshhtë e akuzuara... injorante
26. Baldwin aktor
27. Një pjesë e kandidatëve.
28. Krenar pa çift.
30. Grazia Cucinotta.
32. Paul këngëtar.
33. Janë pëshqjellat.
35. Inicialet e Moravia-s.
37. Pak makinacione.
38. Samuel bomber kamerunas.
40. Markë makine koreane.
41. Ente Kombëtare Durrës.
42. Fillojnë kurat.
43. Inicialet e Zemeckis regjisor.
45. Ekstreme në liter.
46. Fillojnë lejen.


**Fjalëkryqi (2)**

**HORIZONTAL**


1. Satelit i Uranit.
6. Eshhtë edhe ai i Pallës.
11. Tiran pa kufij
12. Në krye të armatës.
13. Një Ibrahim violinist.
14. Qendër ditore.
15. Mund të jenë fotografikë.
17. Inicialet e Einstein.
18. Një mbishkrim në kryq.
20. Janë si vite.
21. Thurman aktore.
22. Të parat në irritim.
23. I preu Seneka.
25. Fillojnë iustrimet
26. Isaac Asimov.
27. Një Vladimir kompozitor.
28. Janë në modë.
30. Janë zyrat... qeveritare
32. Me të nxjerrin trarë.
35. Një shkop, thupër.

**VERTIKAL**


37. Eshhtë Shqipëria e madhe.
39. U thyen në Salamina.
40. Një raport shumë i ngushtë.
41. Nota e diapazonit.
42. Fund heroi.
43. Një top në rrjetë.
45. Gjysma alarmi.
46. Herët pa zë.
47. Sampras i tenisit.
48. Me to bëjnë triko.
49. Një gjuajtje fluturimri në tenis.
50. Janë kokrrat e lisit.
7. Lindin në kokë.
8. Gjysmë shtegu.
9. Hidhen të parat.
10. Eshhtë njeriu i përsosur.
13. Një fjalë për tutje.
15. Fundi i një samurai.
16. Mbyllën me epilog.
17. Bel i maupassant.
19. Inicialet e Redford.
23. I manifeston nxënësi i papërgatitur.
24. Në hyrje të tokës.
26. Pak impresioniste.
27. Janë metrat në sipërfaqe
29. Hapet një për ajër.
30. Gjysmë krenar.
31. Një hidrokarbon.
33. Vrau Hektorin.
34. Një film i rixhiruar.
36. Kupat pa kufij.
38. Inicialet e Nolte aktore.
41. Ullmann aktore.
43. Një brilantinë moderne
44. Hotel pa kufij.
46. Ekstremë në hall.



**Gjeni ndryshimin**



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

**SUDOKU**

7		4							
					6				1
	9	5	7						
4	6		9	3					
	7								9
			5	2	3				
1					9				4
	4			7					

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

**Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar**

5	1	7	6	3	8	2	4	9	
9	4	8	2	5	7	3	6	1	
6	2	3	9	1	4	5	7	8	
4	5	9	3	7	1	6	8	2	
1	3	6	8	2	5	4	9	7	
7	8	2	4	6	9	1	3	5	
8	6	4	5	9	2	7	1	3	
2	9	1	7	4	3	8	5	6	
3	7	5	1	8	6	9	2	4	

*Argëtim filozofik*

- Në fund, e vërteta gjithmonë mbizotëron. Për fat të keq jemi ende në fillim.

- Askush nuk është perfekt dhe askush nuk meriton të jetë i përsosur. Askush nuk e ka të lehtë, të gjithë kanë probleme. Kurrë nuk e di atë që çdokush kalon.

Pra, mendoni para se të filloni të gjykonni dhe të përgeshni të tjerët. Gjithkush bën luftën e tij të veçantë.

- Asnjëherë mos i justifikoni veprimet tuaja. Miqtë tuaj nuk kanë nevojë për këtë, dhe armiqët tuaj nuk do të ju besojnë gjithsesi.

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

1	K	U	7	L	2	T	14	4	9	7	4	19												
8	10	5					1	4	12	2	6	7	5	10										
10	4	7					4	1	2	8	10	6	4	7	5									
18							1	7	5	8	9	4	2	10	4									
6	5	1					6	2	10	5	2	5			12									
							7	1		17	5				1	5	10	17	4	2				
2	5	10	17	4	2					4	10				6	15	5							
8										2	8	12			15					6	10	17	5	
18	10	5	16	19						6					4	8				10	1			
6										7	5				6	11	5			9	19	6	7	
4	11	4	7	6	2	6	1	5							7	17	6							
12	5	2	5							12	1	6	15	4	2									8

**KRIPTOSKEME**

Përgjigja e numrit të djeshëm

M	A	S	H	U	R	K	A	I	R	A	K
E	S	T	E	R	A	D	H	U	N	A	
I	T	E	A	T	E	R	M	I	N		
E	R	A	P	O	L	A	R	K	A		
K	E	L	P	O	L	E	M	I	K	A	T
L	P	O	L	I	G	A	M	I			
E	T	A	P	I	K	A	T	R	E	L	
K	O	M	O	D	E	N	T	O	K	E	
T	R	I	S	E	T	M	N	U	N		
I	T	T	U	T	U	I	T	I	D		
K	A	D	E	T	K	O	S	H	L	E	
E	T	I	K	S	E	K	S	E	R	E	T

**PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR**

**FJALËKRYQI (1)**

**FJALËKRYQI (2)**



*Thënie të mençura*

- E mira ekziston, e keqja duhet të krijohet.
- Liria nuk do të thotë se ju keni kontroll absolut mbi jetën tuaj, do të thotë vetëm që ju mund të zgjidhni atë që dëshironi në një moment të veçantë.
- Vlera që mer diçka që ke fituar, nuk ka të bëjë vetëm me atë që ju ofron, por dhe me çfarë është sakrifikuar për të arritur atë.
- Respekti nuk imponohet, por fitohet.
- Të gabosh është njëzore, por të falësh është hyjnore.
- Me kalimin e viteve, disa vetëm rriten dhe disa bëhen të pjekur.

